LIGJ
Nr. 16/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI) DHE AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM (HUADHËNËSI) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "FURNIZIMI ME UJË I QYTETIT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (huamarrësi) dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi) për financimin e projektit "Furnizimi me ujë i qytetit të Durrësit" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar, më datë 16.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 34, datë 24.2.2023 të Presidentit të Republikës, Bajram Begaj

MARRËVESHJE AFD N° CAL1012 01 Y
MARRËVESHJE E SHUMËS SË KREDISË
E datës 15 nëntor 2022
NDËRMJET AGENCE FRANÇAISE DE DEVELOPPEMENT (HUADHËNËSI) DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (HUAMARRËSI)

Tabela e lëndës

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI
1.1 Përkufizimet
1.2 Interpretimi
2. SHUMA, QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRDORIMIT
2.1 Shuma
2.2. Qëllimi
2.3 Mungesa e përgjegjësisë
2.4 Kushtet pararendëse
3. TËRHEQJA E FONDEVE
3.1 Shumat e tërheqjes së fondit
3.2 Kërkesa për tërheqjen e fondit
3.3 Përfundimi i pagesës
3.4 Mekanizmi i pagesës – pagesat direkte nga Huadhënësi për Kontraktuesit
3.5 Afati për tërheqjen e parë të fondit
3.4 Afati për tërheqjen e fondeve

4. INTERESI
4.1 Norma e interesit
4.2 Llogaritja dhe pagesa e interesit
4.3 Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa
4.4 Komunikimi i normave të interesit
4.5 Norma efektive globale
5. NDRYSHIMI I LLOGARITJES SË INTERESIT
5.1 Mosfunksionimi i tregut
5.2 Zëvendësimi i normës së përqindjes vjetore
6. TARIFAT
6.1 Tarifat e angazhimit
6.2 Tarifa e vlerësimit
7. SHLYERJA
8. PARAPAGIMI DHE ANULIMI
8.1 Parapagimi vullnetar
8.2 Parapagimi i detyrueshëm
8.3 Anulimi nga Huamarrësi
8.4 Anulimi nga Huadhënësi
8.5 Kufizimet
9. DETYRIMET E PAGESËS SHTESË
9.1 Kostot dhe shpenzimet
9.2 Dëmshpërblimi i anulimit
9.3 Dëmshpërblimi i parapagimit
9.4 Taksat dhe tatimet
9.5 Dëmshpërblimi valutor
9.6 Datat e caktuara
10. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË
10.1 Kompetenca dhe autoriteti
10.2 Vlefshmëria dhe pranueshmëria në prova
10.3 Detyrimet e detyrueshme
10.4 Mosdepozitimi ose taksat e pullave
10.5 Transferimi i fondeve
10.6 Mosqenia në konflikt me detyrimet e tjera
10.7 Ligji rregullues dhe zbatimi
10.8 Mospasja e rasteve të mospërmbushjes së detyrimeve
10.9 Mosdhënia e informacionit mashtrues
10.10 Dokumentet e Projektit
10.11 Prokurimet
10.12 Klasifikimi *pari passu*
10.13 Origjina e fondeve, aktet e korrupsionit, mashtrimi dhe praktikat antikonkurruese
10.14 Mospasja e një ndikimi material negativ
11. SIPËRMARRJET
11.1 Pajtueshmëria me ligjet; rregulloret dhe detyrimet
11.2 Autorizimet
11.3. Dokumentet e Projektit
11.4 Zbatimi dhe ruajtja e Projektit
11.5 Prokurimet
11.6. Përgjegjësia mjedisore dhe sociale
11.7 Financimet shtesë
11.8 Klasifikimi *pari passu*
11.9 Delegimi
11.10 Inspektimet
11.11 Vlerësimi i Projektit

11.12 Zbatimi i Projektit
11.13 Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikat antikonkurruese
11.14 Vizibiliteti dhe komunikimi
11.15 Autorizimet e Projektit
12. SIPËRMARRJET E INFORMACIONIT
12.1 Informacioni financiar
12.2 Raporti i progresit
12.3. Informacioni – të ndryshme
13. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE
13.1 Rastet e mospërmbushjes së detyrimeve
13.2 Përshpejtimi
13.3 Njoftimi i një rasti të mospërmbushjes së detyrimit
14. ADMINISTRIMI I SHUMËS
14.1 Pagesat
14.2 Kompensimi
14.3 Ditët e punës
14.4 Valuta e pagesës
14.5 Marrëveshja për numërimin e ditëve
14.6 Vendi i pagesës
14.7 Mosfunksionimi i sistemeve të pagesës
15. TË NDRYSHME
15.1 Gjuha
15.2 Certifikimet dhe përcaktimet
15.3 Pavlefshmëria e pjesshme
15.4 Mosheqja dorë
15.5 Delegimi
15.6 Efekti ligjor
15.7 Marrëveshja e plotë
15.8 Amendimet
15.9 Konfidencialiteti – Zbulimi i informacionit
15.10 Kufizimi
15.11 Shtrëngimi
16. NJOFTIMET
16.1 Me shkrim dhe adresat
16.2 Dorëzimi
16.3 Komunikimet elektronike
17. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE ZGJEDHJA E VENDBANIMIT
17.1 Ligji rregullues
17.2 Arbitrazhi
17.3 Njoftimi i procesit
18. KOHËZGJATJA
Skeduli 1/A. Përkufizimet
Skeduli 1/B. Interpretimi
Skeduli 2. Përshkrimi i Projektit
Skeduli 3. Plani i financimit
Skeduli 4. Kushtet pararendëse
Skeduli 5/A. Forma e kërkesës për tërheqjen e fondit
Skeduli 5/B. Forma e konfirmimit të tërheqjes së fondit dhe norma
Skeduli 5/C. Forma e kërkesës për konvertimin e normës
Skeduli 5/D. Forma e konfirmimit të konvertimit të normës
Skeduli 6. Plani i veprimit mjedisor dhe social
Skeduli 7. Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të Projektit

Skeduli 8. Informacioni që huadhënësi autorizohet shprehimisht të zbulojë në faqen e internetit të Huadhënësit (në veçanti në platformën e tij të hapur të të dhënave)
Skeduli 8-1.Njoftimi për informacionin e transaksionit
Skeduli 9. Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të Projektit
Skeduli 10. Lista joshteruese e dokumenteve mjedisore dhe sociale që Huamarrësi lejon të zbulohen në lidhje me procedurën e punës të mekanizmit të menaxhimit të ankesave
Skeduli 11. Ndarja e të dhënave të biodiversitetit

MARRËVESHJE E SHUMËS SË KREDISË

NDËRMJET

1. *Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë*,

të përfaqësuar nga znj. Delina Ibrahimaj, në cilësinë e saj si ministre e Financave dhe Ekonomisë, e cila është autorizuar sipas rregullave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje

("Huamarrësi");

dhe

2. *Agence Francaise de Developpement*, një ent publik francez i rregulluar nga legjislacioni francez, me zyrë të regjistruar në adresën 5, Rue Roland Barthes, 75598 Paris Ce,dex 12, France, i regjistruar në Regjistrin Tregtar dhe Shoqërive Tregtare të Parisit me numrin 775 665 599, i përfaqësuar nga znj. Cécile Couprie, në cilësinë e saj si drejtor rajonal për Euroazinë, e autorizuar sipas rregullave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje,

("AFD" ose "Huadhënësi");

(në vijim të referuar bashkërisht si "Palët" dhe secila një "Palë");

Duke pasur parasysh se:

A. Huamarrësi synon të përmirësojë shërbimin e furnizimit me ujë në rajonin e Durrësit "Projekti"), siç përshkruhet më tej në skedulin 2 (*Përshkrimi i Projektit*).

B. Huamarrësi ka kërkuar që Huadhënësi të vendosë në dispozicion një shumë për qëllimet e financimit të Projektit;

C. Sipas rezolutës N°C20200792 të Bordit të Drejtorëve, të datës 5 nëntor 2020, Huadhënësi ka rënë dakord të vendosë në dispozicion shumën për Huamarrësin, sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje;

SI RRJEDHOJË, PALËT KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje (përfshirë ato që paraqiten në pikat e mësipërme dhe në skedule) kanë kuptimin që u jepet në skedulin 1.A (*Përkufizimet*), përveç kur përcaktohen ndryshe në këtë Marrëveshje.

1.2 Interpretimi

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Marrëveshje interpretohen në përputhje me dispozitat e skedulit 1 B *(Interpretimi),* nëse nuk shfaqet një synim i kundërt.

2. SHUMA, QËLLIMI DHE KUSHTET E PËRDORIMIT

2.1 Shuma

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje, Huadhënësi i vendos në dispozicion Huamarrësit një shumë në sasi totale maksimale prej gjashtëdhjetë milionë euro (60,000,000 EURO).

2.2 Qëllimi

Huamarrësi do të aplikojë ekskluzivisht të gjitha shumat e marra hua prej tij në kuadër të kësaj shume drejt financimit të projektit, pa përfshirë taksat, në përputhje me përshkrimin e Projektit të përcaktuar në skedulin 2 (*Përshkrimi i Projektit*) dhe planin e financimit të përcaktuar në skedulin 3 (*Plani i financimit*).

2.3 Mungesa e përgjegjësisë

Huadhënësi nuk mban përgjegjësi për përdorimin e ndonjë shume të marrë hua, e cila nuk është në

përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2.4 Kushtet pararendëse

a) Jo më vonë se data e nënshkrimit, Huamarrësi do t'i japë Huadhënësit të gjitha dokumentet e përcaktuara në pjesën I të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*).

b) Një kërkesë për tërheqje fondi nuk mund t'i dorëzohet Huadhënësit, nëse:

i. në rastin e tërheqjes së parë të fondit, Huadhënësi nuk ka marrë të gjitha dokumentet e listuara në pjesën II dhe/ose IV të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*) sipas rastit, dhe nuk ka njoftuar Huamarrësin se dokumente të tilla janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje;

ii. në rastin e tërheqjes së dytë të fondit, Huadhënësi nuk ka marrë të gjitha dokumentet e listuara në pjesën III dhe/ose IV të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*) sipas rastit, dhe nuk ka njoftuar Huamarrësin se dokumente të tilla janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje;

iii. në rastin e tërheqjes së mëtejshme të fondit, Huadhënësi nuk ka marrë të gjitha dokumentet e listuara në pjesën IV të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*) dhe nuk ka njoftuar Huamarrësin se dokumente të tilla janë të pranueshme në formë dhe përmbajtje; dhe

iv. në datën e kërkesës për tërheqje fondi dhe në datën e propozuar të tërheqjes së fondit për Tërheqjen përkatëse të fondit nuk ka ndodhur asnjë rast mosfunksionimi i sistemeve të pagesave dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje janë përmbushur, duke përfshirë:

1. asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve nuk po vijon ose nuk do të rezultojë nga tërheqja e propozuar e fondit;

2. Kërkesa për tërheqjen e fondit është paraqitur në pajtim me kushtet e klauzolës 3.2 (*Kërkesa për tërheqjen e fondit*);

3. Çdo përfaqësim i dhënë nga Huamarrësi në lidhje me klauzolën 10 (*Përfaqësimet dhe garancitë*) është i vërtetë;

3. TËRHEQJA E FONDEVE

3.1 Shumat e tërheqjes së fondit

Shuma do të vendoset në dispozicion të Huamarrësit gjatë periudhës së disponibilitetit, në disa tërheqje fondesh, me kusht që numri i tërheqjeve të fondit të mos kalojë 50 (pesëdhjetë).

Shuma e tërheqjes së propozuar të fondit do të jetë minimumi njëqind mijë euro (100,000 EURO) ose një shumë e barabartë me kredinë në dispozicion[1], nëse kjo shumë është më pak se njëqind mijë euro (100,000 EURO).

3.2 Kërkesa për tërheqjen e fondit

Me kusht që kushtet e përcaktuara në skedulin 4 (*Kushtet pararendëse*) të përmbushen, Huamarrësi mund të tërheqë shumën duke i dorëzuar Huadhënësit një kërkesë për tërheqje fondi të plotësuar sipas rregullave. Huamarrësi do të dorëzojë çdo kërkesë për tërheqje fondi te drejtori i zyrës së AFD-së, në adresën e specifikuar në klauzolën 16.1 (*Me shkrim dhe adresat).*

çdo kërkesë për tërheqje fondi është e parevokueshme dhe do të konsiderohet e plotësuar sipas rregullave, nëse:

a) kërkesa për tërheqje fondi është kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5A (*Forma e kërkesës së tërheqjes së fondit*);

b) kërkesa për tërheqje fondi merret nga Huadhënësi maksimumi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para afatit të tërheqjes së fondit;

c) data e propozuar e tërheqjes së fondit është një ditë pune që hyn në periudhën e disponibilitetit;

d) shuma e tërheqjes së fondit pajtohet me klauzolën 3.1 *(Shumat e tërheqjes së fondit*); dhe

e) të gjitha dokumentet e përcaktuara në pjesën II dhe/ose IV të skedulit 4 (*Kushtet pararendëse*), sipas rastit, për qëllimet e tërheqjes së fondit i bashkëlidhen kërkesës për tërheqje fondi, janë në përputhje me skedulin e lartpërmendur dhe me kërkesat e klauzolës 3.4 (*Mekanizmi i pagesës*) dhe janë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin.

Çdo dëshmi dokumentuese, si faturat ose faturat e paguara, duhet të përfshijë numrin e referencës dhe datën e urdhërpagesës përkatëse. Huamarrësi merr përsipër të mbajë posedimin e origjinaleve të dëshmive dokumentare, për t'i vënë në dispozicion këto dëshmi Huadhënësit në çdo kohë dhe t'i sigurojë Huadhënësit kopje ose dublikatë të vërtetuar të këtyre dëshmive, siç mund të kërkojë Huadhënësi.

---

[1] Kuptohet që kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm për tërheqjen e fundit të fondit në kuadër të shumës, sipas rastit.

3.3 Përfundimi i pagesës

Në bazë të klauzolës 14.7 (*Mosfunksionimi i sistemeve të pagesave*), nëse secili prej kushteve të përcaktuara në klauzolën (b) *(Kushtet pararendëse)* të kësaj Marrëveshjeje është përmbushur, Huadhënësi do të kryejë tërheqjen e kërkuar të fondit në dispozicion të Huamarrësit jo më vonë se data e tërheqjes së fondit.

Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit një letër konfirmimi të tërheqjes së fondit, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5B *(Forma e konfirmimit të tërheqjes së fondit dhe norma).*

3.4 Mekanizmi i pagesës – pagesat direkte nga Huadhënësi për Kontraktuesit

Shuma do të vendoset në dispozicion nëpërmjet pagesave direkte për Kontraktuesit nga Huadhënësi në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) Huamarrësi do të kërkojë në kërkesën për tërheqje fondi që të ardhurat e një tërheqjeje fondi t'i vendosen në dispozicion drejtpërdrejt çdo Kontraktuesi të cilit i detyrohet shumë parash sipas ndonjë kontrate prokurimi për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve të tjera të kryera për qëllime të zbatimit të të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve të pranueshme të Projektit, duke i bashkangjitur kërkesës për tërheqje fondi dokumentet e listuara në pjesën II dhe/ose pjesën IV, sipas rastit, të shtojcës 4 (*Kushtet pararendëse*).

b) Huamarrësi autorizon Huadhënësin të kryejë pagesa direkte në përputhje me paragrafin e mësipërm (a) nga të ardhurat e një tërheqjeje fondi. Huadhënësi nuk do të jetë i detyruar, në çdo kohë, të verifikojë nëse ka një kufizim të çfarëdo natyre në lidhje me tërheqjen e kërkuar të fondit. Huadhënësi rezervon të drejtën të refuzojë një kërkesë të tillë nëse merr dijeni për ndonjë kufizim të tillë.

c) Huadhënësi nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjës në lidhje me tërheqjen e fondeve dhe Huamarrësi heq dorë nga çdo veprim që mund të ketë kundër Huadhënësit në këtë drejtim. Huamarrësi do të dëmshpërblejë Huadhënësin për çdo kosto, humbje ose përgjegjësi që i lind Huadhënësit në lidhje me veprimet e palëve të treta ndaj Huadhënësit, në lidhje me këto tërheqje fondesh.

d) Huamarrësi pranon se çdo shumë e paguar nga Huadhënësi në përputhje me këtë klauzolë 3.4 do të jetë një tërheqje fondi dhe se ai do t'i shlyejë plotësisht Huadhënësit të gjitha shumat e paguara sipas shumës, në përputhje me këtë klauzolë 3.4 (*Mekanizmi i pagesës – pagesat e drejtpërdrejta nga Huadhënësi për kontraktuesit*), së bashku me, dhe duke përfshirë, por pa u kufizuar në të gjithë interesin e llogaritur në ato shuma që nga datat përkatëse të tërheqjes së fondit.

3.5 Afati për tërheqjen e parë të fondit

Tërheqja e parë e fondit do të ndodhë jo më vonë se në datën e skadimit të periudhës 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit.

Nëse tërheqja e parë e fondit nuk ndodh në periudhën e lartpërmendur, Huadhënësi mund të anulojë shumën në përputhje me klauzolën 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*).

Afati për tërheqjen e parë të fondit mund të mos shtyhet pa pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

Çdo shtyrje e afatit për tërheqjen e parë të fondit, do të jetë: i) objekt i një dëmshpërblimi që do të llogaritet në datën e shtyrjes; dhe ii) formalizohet me një shtesë me shkrim ndërmjet Palëve. Dëmshpërblimi do të paguhet nga Huamarrësi për Huadhënësin në datën e kërkueshme pas datës së nënshkrimit të shtesës.

3.6 Afati për tërheqjen e fondeve

Tërheqja e plotë e fondit do të ndodhë jo më vonë se në afatin e tërheqjes së fondit.

Nëse tërheqja e plotë e fondit nuk ndodh deri në datën e lartpërmendur, Huadhënësi mund të anulojë shumën në përputhje me klauzolën 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*).

Afati për tërheqjen e fondit mund të mos shtyhet pa pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

Çdo shtyrje e afatit për tërheqjen e parë të fondit do të jetë: i) subjekt i një dëmshpërblimi që do të llogaritet në datën e shtyrjes; dhe ii) formalizohet me një shtesë me shkrim ndërmjet Palëve. Dëmshpërblimi do të paguhet nga Huamarrësi për Huadhënësin në datën e kërkueshme pas datës së nënshkrimit të shtesës.

4. INTERESI

4.1 Norma e interesit

4.1.1 Përzgjedhja e normës së interesit

Për secilën tërheqje fondi, Huamarrësi mund të zgjedhë një normë fikse interesi ose një normë të ndryshueshme interesi, e cila do të zbatohet për shumën e përcaktuar në kërkesën përkatëse të tërheqjes së fondit, duke deklaruar normën e përzgjedhur të interesit, d.m.th., fikse ose të ndryshueshme, në kërkesën e tërheqjes së fondit të dorëzuar Huadhënësit kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5A *(Forma e kërkesës së tërheqjes së fondit)*, në bazë të kushteve të mëposhtme:

i. Norma e ndryshueshme e interesit

Huamarrësi mund të përzgjedhë një normë të ndryshueshme interesi, e cila do të jetë norma e përqindjes në vit që është totali i:

- EURIBOR-it gjashtëmujor ose sipas rastit, standardi i zëvendësimit plus ndonjë marzh rregullimi, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 5 *(Ndryshimi i llogaritjes së interesit)* të Marrëveshjes; dhe
- Marzhit.

Pavarësisht nga sa më sipër, në rastin e tërheqjes së parë të fondit, nëse periudha e parë e interesit është më e shkurtër se njëqind e tridhjetë e pesë (135) ditë, EURIBOR-i i zbatueshëm do të jetë:

- EURIBOR-i njëmujor ose sipas rastit, standardi i zëvendësimit plus ndonjë marzh rregullimi, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 5 *(Ndryshimi i llogaritjes së interesit)* të Marrëveshjes, nëse periudha e parë e interesit është më e shkurtër se 60 (gjashtëdhjetë) ditë; ose
- EURIBOR-i tremujor ose sipas rastit, standardi i zëvendësimit plus ndonjë marzh rregullimi, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 5 *(Ndryshimi i llogaritjes së interesit)* të Marrëveshjes, nëse periudha e parë e interesit është midis 60 (gjashtëdhjetë) dhe 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) ditëve.

ii. Norma fikse e interesit

Me kusht që shuma e një tërheqjeje të kërkuar fondi të jetë e barabartë ose më e madhe se tre milionë euro (3,000,000 euro), Huamarrësi mund të përzgjedhë një normë fikse interesi për këtë tërheqje të kërkuar fondi. Norma fikse e interesit do të jetë norma fikse e referencës e rritur ose e ulur nga çdo luhatje e normës së indeksit për periudhën nga data e nënshkrimit deri në datën përkatëse të përcaktimit të normës.

Huamarrësi mund të specifikojë në kërkesën e tërheqjes së fondit një shumë maksimale për normën fikse të interesit. Nëse norma fikse e interesit e llogaritur në datën e përcaktimit të normës tejkalon shumën maksimale për normën fikse të interesit të specifikuar në kërkesën përkatëse të tërheqjes së fondit, kjo kërkesë e tërheqjes së fondit do të anulohet dhe shuma e tërheqjes së fondit e specifikuar në kërkesën e anuluar të tërheqjes së fondit do t'i kreditohet kredisë në dispozicion.

4.1.2 Norma minimale e interesit

Norma e interesit e përcaktuar në pajtim me klauzolën 4.1.1 (*Përzgjedhja e normës së interesit*), pavarësisht opsionit të përzgjedhur, nuk duhet të jetë më pak se zero pikë e njëzet e pesë për qind (0.25 %) në vit, pavarësisht ndonjë uljeje në normën e interesit.

4.1.3 Konvertimi nga një normë e ndryshueshme interesi në një normë fikse interesi

i) Konvertimi i normës me kërkesë të Huamarrësit

Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë që Huadhënësi të konvertojë normën e ndryshueshme të Interesit të zbatueshme për një tërheqje fondi ose disa tërheqje fondi në një normë fikse interesi, me kusht që shuma e tërheqjes së fondit ose shuma totale e tërheqjeve të fondeve (sipas rastit) të jetë e barabartë ose më e lartë se tre milionë euro (3,000,000 EURO).

Për këtë qëllim, Huamarrësi i dërgon Huadhënësit një kërkesë për konvertimin e normës, kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5C *(Forma e kërkesës për konvertimin e normës)*. Huamarrësi mund të specifikojë në letrën për konvertimin e normës, një shumë maksimale për normën fikse të Interesit. Nëse norma fikse e Interesit që llogaritet në datën e përcaktimit të normës, tejkalon shumën maksimale për normën fikse të interesit të specifikuar nga Huamarrësi në kërkesën e konvertimit të normës, ajo kërkesë për konvertimin e normës do të anulohet automatikisht.

Norma fikse e interesit do të jetë efektive 2 (dy) ditë pune pas datës së përcaktimit të normës.

ii) Mekanizmi i konvertimit të normës

Norma fikse e interesit e zbatueshme për tërheqjen/et e fondit, do të përcaktohet në përputhje me klauzolën 4.1.1 (ii) (*Norma fikse e interesit)* më lart, në datën e përcaktimit të normës të përmendur në nënparagrafin "i" më lart.

Huadhënësi i dërgon Huamarrësit një letër konfirmimi të konvertimit të normës kryesisht në formën e përcaktuar në skedulin 5D (*Forma e konfirmimit të konvertimit të normës*).

Një konvertim norme është përfundimtar dhe pa kosto.

4.2 Llogaritja dhe pagesa e interesit

Huamarrësi do të paguajë interesin e shtuar mbi tërheqjen/et e fondit në secilën datë pagese.

Shuma e interesit të pagueshëm nga Huamarrësi në një datë përkatëse pagese dhe për një periudhë përkatëse interesi do të jetë e barabartë me shumën e çdo interesi që përbën detyrim nga Huamarrësi mbi shumën e principalit të papaguar në lidhje me secilën tërheqje fondi. Interesi që përbën detyrim nga Huamarrësi në lidhje me secilën tërheqje fondi, do të llogaritet në bazë të:

i. principalit të papaguar që përbën detyrim nga Huamarrësi në lidhje me tërheqjen përkatëse të fondit, në datën e pagesës menjëherë pararendëse ose, në rastin e periudhës së parë të interesit, në datën përkatëse të tërheqjes së fondit;

ii. numrit të saktë të ditëve që janë grumbulluar gjatë periudhës përkatëse të interesit sipas 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditëve në vit; dhe

iii. normës së zbatueshme të interesit të përcaktuar në përputhje me dispozitat e klauzolës 4.1 *(Norma e interesit)*.

4.3 Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa

a) Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa për të gjitha shumat e kërkueshme dhe të papaguara (përveç interesit).

Nëse Huamarrësi nuk paguan ndonjë shumë të pagueshme prej tij ndaj Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje (qoftë pagesën e principalit, dëmshpërblimin e parapagimit, çdo tarifë ose shpenzim të rastësishëm të çdo lloji, përveç ndonjë interesi të papaguar të prapambetur) në datën e caktuar të tij, interesi do të shtohet mbi shumën e prapambetur, në masën e lejuar me ligj, nga data e caktuar deri në datën e pagesës aktuale (si para edhe pas një vendimi arbitrazhi, nëse ka) në normën e interesit të zbatueshme për periudhën aktuale të interesit (kamatëvonesa) të rritur me 3.5% (tri pikë e pesë për qind) (interesi i kamatëvonesës). Asnjë njoftim paraprak zyrtar nga Huadhënësi nuk është i nevojshëm.

b) Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa mbi interesin e papaguar të prapambetur

Interesi që nuk është paguar në datën e caktuar do të ketë interes, me kusht që të kenë mbetur pa u paguar për një vit dhe në masën e lejuar me ligj, në normën e interesit të zbatueshme për periudhën e interesit në vijim (kamatëvonesa), rritur me 3.5% (tri pikë e pesë për qind) (interesi i kamatëvonesës), në atë masë që interesi i tillë ka qenë i kërkueshëm dhe i pagueshëm për të paktën 1 (një) vit. Asnjë njoftim paraprak zyrtar nga Huadhënësi nuk është i nevojshëm.

Huamarrësi paguan çdo interes të papaguar sipas kësaj klauzole 4.3 *(Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa)* menjëherë sipas kërkesës nga Huadhënësi ose në secilën datë pagese pas datës së caktuar për pagesën e papaguar.

c) Marrja e ndonjë pagese interesi të pagesës së vonuar ose kamatëvonesës nga Huadhënësi nuk nënkupton miratimin e ndonjë zgjatjeje të afatit të pagesës ndaj Huamarrësit dhe as nuk vepron si heqje dorë nga ndonjë prej të drejtave të Huadhënësit më poshtë.

4.4 Komunikimi i normave të interesit

Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për caktimin e secilës normë interesi në përputhje me këtë Marrëveshje.

4.5 Norma globale në fuqi

Në mënyrë që të pajtohen me nenet L. 314-1 deri L.314-5 dhe R.314-1 *etj.,* të Kodit francez të Konsumatorit dhe L. 313-4 të Kodit Monetar dhe Financiar francez, Huadhënësi informon Huamarrësin dhe Huamarrësi pranon që norma globale në fuqi, e zbatueshme për këtë shumë, mund të vlerësohet në një normë vjetore prej 4.74% (katër pikë e shtatëdhjetë e katër për qind) në bazë të 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditëve në vit dhe një periudhe interesi prej 6 (gjashtë) muajsh në bazë të sa më poshtë:

a) normat e mësipërme janë dhënë vetëm për qëllime informimi;

b) normat e mësipërme llogariten mbi bazën, se:

i. tërheqja e fondit të shumës është e plotë në datën e nënshkrimit;

ii. asnjë tërheqje fondi e vënë në dispozicion të Huamarrësit nuk do të ketë interes mbi normën e ndryshueshme; dhe

iii. norma fikse për kohëzgjatjen e shumës duhet të jetë e barabartë katër pikë e pesëdhjetë e gjashtë për qind (4.56%);

c) normat e mësipërme marrin parasysh tarifat dhe kostot e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, duke supozuar se tarifa dhe kosto të tilla do të mbeten fikse dhe do të zbatohen deri në përfundimin e afatit të kësaj Marrëveshjeje.

5. NDRYSHIMI I LLOGARITJES SË INTERESIT

5.1 Mosfunksionimi i tregut

a) Nëse një mosfunksionim tregu prek tregun ndërbankar në Eurozonë dhe nëse është e pamundur:

i. për normën fikse të interesit, për të përcaktuar normën fikse të interesit të zbatueshme për një tërheqje fondi, ose

ii. për normën e ndryshueshme të interesit, për të përcaktuar EURIBOR-in e zbatueshëm për periudhën përkatëse të interesit,

Huadhënësi do të informojë Huamarrësin.

b) Pas ndodhisë së rastit të përshkruar në paragrafin "a" më lart, norma e zbatueshme e interesit, sipas rastit, për tërheqjen përkatëse të fondit ose për periudhën përkatëse të interesit, do të jetë shuma e:

i. Marzhit; dhe

ii. normës së përqindjes në vit që korrespondon me koston e Huadhënësit të financimit të tërheqjes/eve përkatëse të fondeve nga cilido burim që mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme. Kjo normë do t'i njoftohet Huamarrësit sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, para: 1) datës së parë të pagesës për interesin që i detyrohet sipas kësaj tërheqjeje fondi për normën fikse të interesit ose 2) datës së pagesës për interesin që i detyrohet sipas kësaj periudhe interesi për normën e ndryshueshme të interesit.

5.2. Zëvendësimi i normës së përqindjes vjetore

5.2.1 Përkufizimet

"**Organ kompetent emërues**" nënkupton çdo bankë qendrore, rregullator, mbikëqyrës ose grup pune ose komitet të sponsorizuar ose të kryesuar nga, ose të përbërë me kërkesën e ndonjë prej tyre.

"**Rast zëvendësimi i normës së përqindjes vjetore**" nënkupton ndonjë prej rasteve ose serive të rasteve të mëposhtme:

a) përkufizimi, metodologjia, formula ose mënyra e përcaktimit të normës së përqindjes vjetore ka ndryshuar nga pikëpamja materiale;

b) është miratuar një ligj ose rregullore që ndalon përdorimin e normës së përqindjes vjetore, duke specifikuar, për shmangien e dyshimit, se ndodhia e këtij rasti nuk do të përbëjë rast të detyrueshëm parapagimi;

c) administratori i normës së përqindjes vjetore ose mbikëqyrësi i saj njofton publikisht:

i. se ai ka ndërprerë ose do të ndërpresë për një periudhë të përhershme ose të pacaktuar ofrimin e normës së përqindjes vjetore dhe në atë kohë, asnjë administrator pasues nuk është emëruar publikisht që të vijojë të ofrojë atë normë të përqindjes vjetore;

ii. se norma e përqindjes vjetore është ndërprerë ose do të ndërpritet së publikuari për një periudhë të përhershme ose të pacaktuar; ose

iii. se norma e përqindjes vjetore nuk mund të përdoret më (qoftë aktualisht ose në të ardhmen);

d) është bërë një njoftim publik në lidhje me falimentimin e administratorit të asaj norme të përqindjes vjetore ose ndonjë procesi tjetër të paaftësisë paguese ndaj tij dhe në atë kohë, asnjë administrator pasues nuk është emëruar publikisht që të vijojë të ofrojë atë normë të përqindjes vjetore; ose

e) sipas mendimit të Huadhënësit, norma e përqindjes vjetore është ndërprerë së përdoruri në një seri transaksionesh të ngjashme financimi.

"**Normë e përqindjes vjetore**" nënkupton EURIBOR-in ose pas zëvendësimit të kësaj norme nga një standard zëvendësues, standardin zëvendësues.

"**Datë e zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore**" nënkupton:

- në lidhje me rastet e përmendura në pikat "a", "d" dhe "e" të përkufizimit të mësipërm të rastit të zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore, datën kur Huadhënësi ka dijeni për ndodhinë e një rasti të tillë, dhe,

- në lidhje me rastet e përmendura në pikat "b" dhe "c" të përkufizimit të mësipërm të rastit të zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore, datën pas së cilës do të ndalohet përdorimi i normës së përqindjes vjetore ose datën kur administratori i normës së përqindjes vjetore, në periudhë të përhershme ose të pacaktuar, ndërpret dhënien e normës së përqindjes vjetore ose datën pas të cilës norma e përqindjes vjetore nuk mund të përdoret më.

5.2.2 Çdo Palë pranon dhe bie dakord për përfitimin e Palës tjetër që nëse ndodh një rast i normës së përqindjes vjetore dhe për të ruajtur ekuilibrin ekonomik të Marrëveshjes, Huadhënësi mund të zëvendësojë normën e përqindjes vjetore me një normë tjetër *("Standardi i zëvendësimit")*, e cila mund të përfshijë një marzh rregullimi, në mënyrë që të shmanget çdo transferim i vlerës ekonomike ndërmjet Palëve (nëse ka) *("Marzhi i rregullimit")* dhe Huadhënësi do të përcaktojë datën nga e cila standardi i zëvendësimit dhe, nëse ka, marzhi i rregullimit do të zëvendësojë normën e përqindjes vjetore dhe çdo ndryshim tjetër të Marrëveshjes që kërkohet si rezultat i zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore nga standardi i zëvendësimit

5.2.3 Përcaktimi i standardit të zëvendësimit dhe ndryshimet e nevojshme do të bëhen në mirëbesim dhe duke pasur parasysh: i) rekomandimet e çdo organi përkatës emërues; ose ii) rekomandimet e administratorit të normës së përqindjes vjetore; ose iii) zgjidhjen e industrisë të rekomanduar nga shoqatat profesionale në sektorin bankar; ose iv) praktikën e tregut të vëzhguar në një seri transaksionesh të ngjashme të financimit në datën e zëvendësimit.

5.2.4 Në rast të zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore, huadhënësi do të njoftojë menjëherë huamarrësin për termat dhe kushtet e zëvendësimit për të zëvendësuar normën e përqindjes vjetore me standardin e zëvendësimit, i cili do të jetë i zbatueshëm për periudhat e interesit, duke filluar të paktën dy ditë pune pas datës së zëvendësimit të normës së përqindjes vjetore.

5.2.5 Dispozitat e klauzolës 5.2 *(Zëvendësimi i normës së përqindjes vjetore)* do të kenë përparësi ndaj dispozitave të klauzolës 5.1 *(Mosfunksionimi i tregut).*

6. TARIFAT

6.1 Tarifat e angazhimit

Duke filluar nga data që bie 9 (nëntë) muaj pas datës së nënshkrimit dhe në vazhdim, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një tarifë angazhimi prej zero pikë pesë për qind (0, 5%) në vit.

Tarifa e angazhimit do të llogaritet me normën e specifikuar më lart mbi shumën e kredisë së disponueshme të vlerësuar proporcionalisht për numrin aktual të ditëve të kaluara, rritur me shumën e çdo tërheqje fondi që duhet të vihet në dispozicion nga Huadhënësi në përputhje me çdo kërkesë të mbetur pezull për tërheqje fondi.

Tarifa e parë e angazhimit do të llogaritet për periudhën (i) nga data e nënshkrimit (përjashtuar) deri në (ii) datën e pagesës që bie menjëherë më pas (përfshirë). Tarifat vijuese të angazhimit llogariten për periudhat që fillojnë në ditën menjëherë pas datës së pagesës (përfshirë) dhe që përfundojnë në datën e ardhshme të pagesës (përfshirë).

Tarifa e shtuar e angazhimit do të paguhet: i) në secilën datë të pagesës brenda periudhës së disponibilitetit; ii) në datën e pagesës pas ditës së fundit të periudhës së tërheqjes së fondit; dhe iii) në rast se kredia në dispozicion anulohet plotësisht, në datën e pagesës pas datës së hyrjes në fuqi të një anulimi të tillë.

6.2 Tarifa e vlerësimit

Jo më vonë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit dhe përpara Tërheqjes së parë të fondit, ose brenda një muaj pas datës së hyrjes në fuqi, cilado datë e specifikuar më sipër ndodh më shpejt, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një tarifë vlerësimi prej 0.5% (zero pikë pesë për qind) e llogaritur në sasinë maksimale të shumës.

7. SHLYERJA

Pas skadimit të periudhës pa interes, Huamarrësi do t'i shlyejë Huadhënësit sasinë e principalit të shumës në 30 (tridhjetë) këste gjashtëmujore, të kërkueshme dhe të pagueshme në secilën datë të pagesës.

Kësti i parë është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në datën 30 prill 2028 dhe kësti i fundit është i kërkueshëm dhe i pagueshëm më datë 31 tetor 2042.

Në përfundim të periudhës së tërheqjes së fondit, Huadhënësi do t'i dorëzojë Huamarrësit një skedul amortizimi në lidhje me shumën, duke marrë parasysh, nëse është e zbatueshme, çdo anulim të

mundshëm të shumës në përputhje me klauzolat 8.3 *(Anulimi nga Huamarrësi)* dhe/ose 8.4 *(Anulimi nga Huadhënësi)*.

8. PARAPAGIMI DHE ANULIMI

8.1 Parapagimi vullnetar

Huamarrësi nuk ka të drejtë të parapaguajë të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës para skadimit të periudhës së tërheqjes së fondit.

Që nga data pas skadimit të periudhës së tërheqjes së fondit, Huamarrësi mund të parapaguajë të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës, në bazë të kushteve të mëposhtme:

a) Huamarrësi do të njoftojë Huadhënësin mbi synimin e tij për të parapaguar me njoftim të parevokueshëm dhe me shkrim jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë para datës së parashikuar të parapagimit;

b) shuma për t'u parapaguar do të jetë e barabartë me një ose disa këste (a) në principal;

c) data e parashikuar e parapagimit do të jetë një datë pagese;

d) të gjitha parapagimet do të kryhen së bashku me pagimin e interesit të shtuar, çdo tarifë, dëmshpërblim dhe kostot e ngjashme në lidhje me shumën e parapaguar siç parashikohet sipas kësaj Marrëveshjeje;

e) nuk ka ndonjë shumë të papaguar; dhe

f) në rast të parapagimit të një pjese, Huamarrësi do të ketë dhënë prova të pranueshme për Huadhënësin, se ka fonde të mjaftueshme të angazhuara në dispozicion për financimin e Projektit, siç përcaktohet në planin e financimit.

Në datën e pagesës kur është kryer parapagimi, Huamarrësi do të paguajë shumën e plotë të dëmshpërblimeve të parapagimit, të kërkueshme dhe të pagueshme në pajtim me klauzolën 9.3 *(Dëmshpërblimi i parapagimit)*.

8.2 Parapagimi i detyrueshëm

Huamarrësi duhet të parapaguajë menjëherë të gjithë ose një pjesë të shumës pas marrjes së një njoftimi nga Huadhënësi që informon Huamarrësin për ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) Paligjshmëria: bëhet e paligjshme që Huadhënësi, sipas ligjit të tij të zbatueshëm, të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij siç parashikohet nga kjo Marrëveshje ose të financojë ose mirëmbajë Shumën;

b) Mospërmbushja e detyrimeve: Huadhënësi shpall një rast të mospërmbushjes së detyrimeve në përputhje me klauzolën 13 (*Rastet e mospërmbushjeve të detyrimeve*);

Në rast të secilit prej rasteve të specifikuara në paragrafët "a" dhe "b" më lart, Huadhënësi rezervon të drejtën, pasi ta ketë njoftuar Huamarrësin me shkrim, që të ushtrojë të drejtat e tij si kreditor në mënyrën e specifikuar në paragrafin "b" të klauzolës 13.2 *(Përshpejtimi)*.

8.2 Anulimi nga Huamarrësi

Para afatit të tërheqjes së fondit, Huamarrësi mund të anulojë të gjithë ose ndonjë pjesë të kredisë në dispozicion, duke i dhënë Huadhënësit njoftim paraprak 3 (tri) ditë pune para.

Pas marrjes së një njoftimi të tillë të anulimit, Huadhënësi anulon shumën e njoftuar nga Huamarrësi, me kusht që shpenzimet e pranueshme, siç specifikohen në planin e financimit, të mbulohen në një mënyrë të pranueshme për Huadhënësin, përveç në rast se Projekti është ndërprerë nga Huamarrësi.

8.3 Anulimi nga Huadhënësi

Kredia në dispozicion do të anulohet menjëherë pas dorëzimit të një njoftimi te Huamarrësi që do të jetë menjëherë efektiv, nëse:

a) kredia në dispozicion nuk është e barabartë me zero në afatin për tërheqjen e fondit;

b) tërheqja e parë e fondit nuk ka ndodhur në datën e skadimit të një periudhe 12-mujore (dymbëdhjetëmujore) nga data e nënshkrimit;

c) ka ndodhur dhe është duke vijuar një rast i mospërmbushjes së detyrimeve;

d) ka ndodhur një rast i përmendur në klauzolën 8.2 *(Parapagimi i detyrueshëm)*; ose

me përjashtim kur, në rastin e paragrafëve "a" dhe "b" të kësaj klauzole 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*), Palët kanë rënë dakord me shkrim që të shtyjnë afatin e tërheqjes së fondit ose afatin e tërheqjes së parë të fondit në bazë të dëmshpërblimit që do të paguhet nga Huamarrësi për Huadhënësin në zbatim të klauzolës 3.5 (*Afati për tërheqjen e parë të fondit*) dhe/ose klauzolën 3.6 (*Afati për tërheqjen e fondeve*), sipas rastit.

8.5 Kufizimet

a) Çdo njoftim i parapagimit ose anulimit i dhënë nga një Palë në përputhje me këtë klauzolë 8 *(Parapagimi dhe anulimi)* do të jetë i parevokueshëm dhe përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, çdo njoftim i tillë specifikon datën ose datat kur do të kryhet parapagimi ose anulimi përkatës dhe shuma e atij parapagimi ose anulimi.

b) Huamarrësi nuk do të parapaguajë ose anulojë të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës, përveç në kohën dhe mënyrën e parashikuar shprehimisht në këtë Marrëveshje.

c) Çdo parapagim sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet së bashku me pagesën e: i) interesit të shtuar mbi shumën e parapaguar; ii) tarifat e papaguara; dhe iii) dëmshpërblimin e parapagimit të përmendur në klauzolën 9.3 (*Dëmshpërblimi i parapagimit*).

d) Çdo shumë parapagimi do të aplikohet ndaj kësteve të mbetura në rend të anasjellë maturimi.

e) Huamarrësi nuk mund të rimarrë hua të gjithë ose ndonjë pjesë të shumës që është parapaguar ose anuluar.

9. DETYRIMET E PAGESAVE SHTESË

9.1 Kostot dhe shpenzimet

9.1.1 Huamarrësi do të rimbursojë Huadhënësin për të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifat ligjore) të shkaktuara prej tij në lidhje me zbatimin ose ruajtjen e ndonjë prej të drejtave të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.1.2 Huamarrësi do të paguajë drejtpërdrejt ose, nëse është e zbatueshme, do të rimbursojë Huadhënësin në rast të një paradhënieje të bërë nga Huadhënësi, shumën e të gjitha kostove dhe shpenzimeve në lidhje me transferimin e fondeve për, ose për llogari të Huamarrësit nga Parisi në çdo vend tjetër të rënë dakord me Huadhënësin, si dhe çdo tarifë transferimi dhe shpenzimi në lidhje me pagesën e të gjitha shumave të kërkueshme sipas shumës.

9.2 Dëmshpërblimi i anulimit

Nëse shuma anulohet plotësisht ose pjesërisht në përputhje me kushtet e klauzolave 8.3 *(Anulimi nga Huamarrësi)* dhe/ose 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*) paragrafët "a", "b" dhe "c", Huamarrësi do të paguajë një dëmshpërblim anulimi të llogaritur në dy pikë pesë për qind (2.5%) mbi sasinë e anuluar të shumës.

Çdo dëmshpërblim anulimi do të jetë i kërkueshëm dhe i pagueshëm në datën e pagesës menjëherë pas anulimit të të gjithë ose një pjese të shumës.

9.3 Dëmshpërblimi i parapagimit

Për shkak të humbjeve të pësuara nga Huadhënësi, si rezultat i parapagimit të plotë ose të pjesshëm të shumës, në përputhje me klauzolat 8.1 *(Parapagimi vullnetar)* ose 8.2 *(Parapagimi i detyrueshëm),* Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit një dëmshpërblim të barabartë me shumën totale të:

- Dëmshpërblimit kompensues të parapagimit; dhe
- çdo kosto që lind nga shkelja e ndonjë transaksioni shkëmbimi për mbrojtjen e interesit, të vënë në funksionim nga Huadhënësi në lidhje me shumën e parapaguar.

9.4 Taksat dhe tatimet

9.4.1 Kostot e regjistrimit

Huamarrësi do të paguajë drejtpërdrejt ose nëse është e zbatueshme, do të rimbursojë Huadhënësin në rast të një parapagimi të bërë nga Huadhënësi, kostot e të gjitha detyrimeve të pullës, regjistrimit dhe taksave të tjera të ngjashme që paguhen në lidhje me Marrëveshjen dhe çdo ndryshim të mundshëm të saj.

9.4.2 Taksa e mbajtjes në burim

Huamarrësi merr përsipër që të gjitha pagesat e bëra ndaj Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë pa taksë të mbajtur në burim.

Nëse një taksë e mbajtur në burim kërkohet me ligj, Huamarrësi ndërmerr që të rrisë shumën e çdo pagese të tillë në një shumë të tillë që i lë Huadhënësit një shumë të barabartë me pagesën e cila do të kishte qenë e kërkueshme, nëse nuk do të ishte kërkuar pagesa e taksës së mbajtur në burim.

Huamarrësi do t'i rimbursojë Huadhënësit të gjitha shpenzimet dhe/ose taksat për llogari të Huamarrësit, të cilat janë paguar nga Huadhënësi (nëse është e zbatueshme), me përjashtim të taksave të kërkueshme në Francë.

9.5 Dëmshpërblimi valutor

Nëse ndonjë shumë e kërkueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë urdhër,

gjykim ose vendim i dhënë ose marrë në lidhje me një shumë të tillë, duhet të konvertohet nga valuta në të cilën ajo shumë paguhet në një valutë tjetër, për qëllimin, e:

i. bërjes ose paraqitjes së një kërkese ose prove kundër Huamarrësit; ose

ii. marrjes ose zbatimit të një urdhri, gjykimi ose vendimi në lidhje me ndonjë proces gjyqësor ose arbitrazhi;

iii. Huamarrësi do të dëmshpërblejë Huadhënësin kundër dhe, brenda 3 (tri) ditësh pune nga kërkesa e Huadhënësit dhe siç lejohet me ligj, do t'i paguajë Huamarrësit shumën e çdo kostoje, humbjeje ose detyrimi që rrjedh nga ose si rezultat i konvertimit, duke përfshirë çdo mospërputhje midis: A) kursit të këmbimit të përdorur për të konvertuar shumën përkatëse nga valuta e parë në valutën e dytë; dhe B) kursit të këmbimit ose kursit/eve në dispozicion të Huadhënësit në kohën e marrjes nga ana e tij të asaj shume. Ky detyrim për dëmshpërblimin e Huadhënësit është i pavarur nga çdo detyrim tjetër i Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë në ndonjë juridiksion, për të paguar ndonjë shumë të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në një valutë ose njësi valute përveç asaj në të cilën shprehet se është e pagueshme.

9.6 Datat e caktuara

Çdo dëmshpërblim ose rimbursim i pagueshëm nga Huamarrësi ndaj Huadhënësit sipas kësaj klauzole 9 *(Detyrimet e pagesës shtesë)* është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në datën e pagesës menjëherë pas rrethanave që kanë shkaktuar dëmshpërblimin ose rimbursimin përkatës.

Pavarësisht sa më sipër, çdo dëmshpërblim që duhet të paguhet në lidhje me një parapagim në përputhje me klauzolën 9.3 *(Dëmshpërblimi i parapagimit)* është i kërkueshëm dhe i pagueshëm në datën e parapagimeve përkatëse.

10. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë klauzolë 10 *(Përfaqësimet dhe garancitë)* janë bërë nga Huamarrësi në interes të Huadhënësit në datën e nënshkrimit. Të gjitha përfaqësimet dhe garancitë në këtë klauzolë 10 *(Përfaqësimet dhe garancitë)* gjithashtu konsiderohen të jenë bërë nga Huamarrësi në datën kur të gjitha kushtet pararendëse të listuara në pjesën II të skedulit 4 *(Kushtet pararendëse)* të jenë përmbushur, në datën e secilës kërkesë për tërheqje fondi, në secilën datë të tërheqjes së fondit dhe në secilën datë pagese, përveç kur përfaqësimet që përsëriten në përmbajtje të klauzolës 10.9 *(Mosdhënia e informacionit mashtrues)* konsiderohen të bëhen nga Huamarrësi në lidhje me informacionin e dhënë nga Huamarrësi që prej datës kur është bërë së fundi përfaqësimi.

10.1 Kompetenca dhe autoriteti

Huamarrësi ka kompetencën të lidhë këtë Marrëveshje dhe të kryejë të gjitha detyrimet e parashikuara. Huamarrësi ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar lidhjen e kësaj Marrëveshjeje.

10.2 Vlefshmëria dhe pranueshmëria në prova

Të gjitha autorizimet e kërkuara për ta bërë këtë Marrëveshje të pranueshme në prova në gjykatat e juridiksionit të Huamarrësit ose në procedurat e arbitrazhit, siç përcaktohet në klauzolën 17 (*Ligji rregullues, zbatimi dhe zgjedhja e vendbanimit*) janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë, dhe nuk ekziston asnjë rrethanë që mund të rezultojë në revokimin, mosrinovimin ose modifikimin, tërësisht ose pjesërisht, të autorizimeve të tilla.

10.3 Detyrimet e detyrueshme

Detyrimet e shprehura për t'u marrë përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumentet e Projektit janë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme për Huamarrësin në juridiksionin e tij dhe janë detyrime ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme, të cilat janë në fuqi në përputhje me kushtet e tyre me shkrim.

10.4 Mosdepozitimi ose taksat e pullave

Sipas ligjeve të Huamarrësit, nuk është e nevojshme që kjo Marrëveshje të depozitohet, shënohet ose regjistrohet në ndonjë gjykatë ose autoritet tjetër në atë juridiksion ose që taksa e pullës, regjistrimit ose taksa ose tarifa të ngjashme të paguhen për ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose transaksionet e parashikuara në të.

10.5 Transferimi i fondeve

Të gjitha shumat e kërkueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje, qoftë si

principal ose interes, interesi i pagesës së vonuar, dëmshpërblimi i parapagimit, kostot dhe shpenzimet e rastësishme ose ndonjë shumë tjetër janë lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

Ky përfaqësim do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë deri në shlyerjen e plotë të të gjitha shumave të kërkueshme për Huadhënësin. Në rast se datat e shlyerjes së shumës shtyhen nga Huadhënësi, asnjë konfirmim i mëtejshëm i këtij përfaqësimi nuk do të jetë i nevojshëm.

Huamarrësi do të marrë euro të nevojshme për pajtueshmërinë me këtë përfaqësim në kohën e duhur.

10.6 Mosqenia në konflikt me detyrimet e tjera

Lidhja dhe përmbushja nga Huamarrësi, dhe transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe dokumentet e Projektit nuk bien ndesh me ndonjë ligj apo rregullore të brendshme ose të huaj të zbatueshme për të, dokumentet e tij kushtetuese (ose ndonjë dokument të ngjashëm) ose ndonjë marrëveshje ose instrument detyrues për Huamarrësin ose që cenon ndonjë prej aseteve të tij.

10.7 Ligji rregullues dhe zbatimi

a) Zgjedhja e ligjit francez si ligj rregullues i kësaj Marrëveshjeje do të njihet dhe zbatohet nga gjykatat dhe gjykatat e arbitrazhit në juridiksionin e Huamarrësit.

b) Çdo gjykim i marrë në lidhje me këtë Marrëveshje në një gjykatë franceze ose çdo vendim nga një gjykatë arbitrazhi do të njihet dhe zbatohet në juridiksionin e themelimit të Huamarrësit.

10.8 Mospasja e rasteve të mospërmbushjes së detyrimeve

Asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve nuk po vazhdon ose në mënyrë të arsyeshme nuk mund të ndodhë.

Asnjë shkelje e Huamarrësit nuk po vazhdon në lidhje me ndonjë marrëveshje tjetër detyruese për të, ose që cenon ndonjë prej aseteve të tij, i cili ka ose mund të ketë ndikim material negativ.

10.9 Mospasja e informacionit mashtrues

Të gjitha informacionet dhe dokumentet e dhëna nga Huamarrësi te Huadhënësi ishin të vërteta, të sakta dhe të përditësuara nga data kur janë siguruar ose, nëse është e nevojshme, nga data në të cilën janë deklaruar se janë dhënë dhe nuk janë ndryshuar, revokuar, anuluar ose rinovuar me kushte të rishikuara, dhe nuk janë mashtruese në ndonjë aspekt material si rezultat i një mosveprimi, ndodhisë së rrethanave të reja ose zbulimit ose moszbulimit të ndonjë informacioni.

10.10 Dokumentet e Projektit

Dokumentet e projektit përfaqësojnë të gjithë marrëveshjen në lidhje me Projektin në datën e nënshkrimit dhe janë të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme ndaj palëve të treta. Dokumentet e Projektit nuk janë ndryshuar, përfunduar ose pezulluar pa miratimin paraprak të Huadhënësit që nga data në të cilën ato i janë dorëzuar Huadhënësit dhe nuk ka asnjë mosmarrëveshje aktuale në lidhje me vlefshmërinë e dokumenteve të Projektit.

10.11 Prokurimi

Huamarrësi: i) ka marrë një kopje të udhëzimeve të prokurimit; dhe ii) kupton kushtet e udhëzimeve të prokurimit, në veçanti, ato kushte që lidhen me çdo veprim të cilat Huadhënësi mund të marrë në rast të shkeljes së udhëzimeve të prokurimit nga Huamarrësi.

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM është i lidhur kontraktualisht nga udhëzimet e prokurimit, sikur udhëzime të tilla të prokurimit të ishin përfshirë duke iu referuar kësaj Marrëveshjeje.

10.12 Klasifikimi *pari passu*

Detyrimet e pagesës të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjithë kreditorëve të tij të pasiguruar dhe prioritarë.

10.13 Origjina e fondeve, aktet e korrupsionit, mashtrimi dhe praktikat antikonkurruese

a) Huamarrësi përfaqëson dhe garanton se të gjitha fondet e përdorura për zbatimin e Projektit, janë nga të ardhurat e shumës dhe grantit të vendosur në dispozicion nga AFD-ja siç përcaktohet në planin e financimit.

d) Projekti (në veçanti, negocimi, dhënia dhe ekzekutimi i çdo kontrate të financuar me shumën) nuk ka shkaktuar asnjë akt korrupsioni, mashtrimi ose praktikë kundër konkurrencës. Ky përfaqësim zbatohet nga data e hyrjes në fuqi.

10.14 Mospasja e një ndikimi material negativ

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton që asnjë rast apo rrethanë që mund të ketë ndikim material negativ nuk ka ndodhur ose nuk mund të ndodhë.

11. SIPËRMARRJET/ANGAZHIMET

Sipërmarrjet/angazhimet në këtë klauzolë 11 (*Sipërmarrjet)* do të hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë për aq kohë sa shuma është e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.1 Respektimi i ligjeve, rregulloreve dhe detyrimeve

Huamarrësi nëpërmjet MIE/ AKUM zbaton,

a) në të gjitha aspektet, të gjitha ligjet dhe rregulloret, të cilave i nënshtrohet ai dhe /ose Projekti, veçanërisht në lidhje me të gjitha ligjet e zbatueshme të mbrojtjes së mjedisit, sigurisë dhe punës; dhe

b) me të gjitha detyrimet e tij sipas dokumenteve të Projektit.

11.2 Autorizimet

Huamarrësi do të marrë menjëherë, do të respektojë dhe do të bëjë gjithçka që është e nevojshme për të ruajtur në fuqi dhe efekt të plotë çdo autorizim të kërkuar në bazë të ndonjë ligji ose rregulloreje në fuqi, për t'i mundësuar atij të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të Projektit dhe të garantojë ligjshmërinë, vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe pranueshmërinë në prova të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo dokumenti të Projektit.

11.3 Dokumentet e Projektit

Huamarrësi do t'i sigurojë Huadhënësit për asnjë kundërshtim ose informacion, sipas rastit, një kopje të çdo dokumenti të Projektit ose ndryshimi të tij dhe nuk do të (dhe nuk pranon që) bëjë ndonjë ndryshim material në ndonjë dokument Projekti pa marrë paraprakisht moskundërshtimin e Huadhënësit.

11.4 Zbatimi dhe ruajtja e Projektit

Huamarrësi:

i. zbaton Projektin në përputhje me parimet përgjithësisht të pranuara të sigurisë dhe në përputhje me standardet teknike në fuqi; dhe

ii. mirëmban asetet e Projektit në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, dhe në kushte të mira operimi dhe mirëmbajtjeje, dhe përdor këto asete në përputhje me qëllimin e tyre dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

11.5 Prokurimi

Në lidhje me prokurimin, dhënien dhe zbatimin e kontratave të lidhura në lidhje me zbatimin Projektit, Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do të respektojë, dhe zbatojnë dispozitat e udhëzimeve të prokurimit.

Huamarrësi nëpërmjet MIE/ AKUM do të ndërmarrë të gjitha veprimet dhe hapat e nevojshëm për zbatimin e efektshëm të udhëzimeve të prokurimit.

11.6 Përgjegjësia mjedisore dhe sociale

11.6.1 Zbatimi i masave mjedisore dhe sociale

Për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, Palët bien dakord se është e nevojshme të promovohet përputhshmëria me standardet e njohura ndërkombëtarisht mjedisore dhe të punës, përfshirë konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ("ONP") dhe ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare mjedisore në fuqi në juridiksionin e Huamarrësit. Për këtë qëllim, Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM:

në lidhje me aktivitetet e tij të biznesit:

a) zbaton standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e legjislacionit të mjedisit dhe punës, veçanërisht konventat themelore të ONP-së dhe konventat ndërkombëtare mjedisore, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të vendit në të cilin po zbatohet Projekti.

në lidhje me Projektin:

b) përfshin në kontratat e prokurimit dhe, sipas rastit, në dokumentet e tenderit, një klauzolë ku palët kontraktuese bien dakord dhe bien dakord të sigurojnë që nënkontraktuesit e tyre (nëse ka) të bien dakord të respektojnë standardet e tilla në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Huadhënësi do të ketë të drejtë të kërkojë që Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM të dorëzojë një raport mbi kushtet mjedisore dhe sociale të zbatimit të Projektit;

c) vendos në funksion masat e duhura zbutëse specifike për Projektin, siç përcaktohet në kontekstin e politikës së menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social të Projektit dhe përshkruan në ESCP-në bashkëlidhur si shtojca 6 (*Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social*);

d) kërkon që Kontraktuesit e caktuar për zbatimin e Projektit, të zbatojnë masat zbutëse të përcaktuara në paragrafin "c" më sipër dhe të sigurojnë që nënkontraktuesit e tyre (nëse ka) të respektojnë të gjitha masat e tilla dhe të marrin të gjitha hapat e duhur në rast të dështimit për të vendosur në funksion masa të tilla zbutëse; dhe

e) i siguron Huadhënësit raportet vjetore të ndjekjes në lidhje me ESCP.

11.6.2 Menaxhimi i ankesave mjedisore dhe sociale (E&S)

a) Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM: i) konfirmon se ai ka marrë një kopje të procedurës së punës të mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S dhe ka pranuar kushtet e tij, veçanërisht në lidhje me veprimet që mund të ndërmerren nga Huadhënësi në rast se një palë e tretë paraqet ankesë; dhe ii) pranon që procedurat e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S kanë, si midis Huamarrësit dhe Huadhënësit, të njëjtin efekt detyrues kontraktues si kjo Marrëveshje.

b) Huamarrësi, nëpërmjet MIE/AKUM, autorizon shprehimisht Huadhënësin që t'u zbulojë ekspertëve (siç përcaktohet në procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave E&S) dhe palëve të përfshira në auditimin e pajtueshmërisë dhe/ose procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, dokumentet e Projektit në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale të nevojshme për trajtimin e ankesës mjedisore dhe sociale, duke përfshirë, pa kufizim, ato të listuara në skedulin 10 (*Lista joshteruese e dokumenteve mjedisore dhe sociale, të cilat Huamarrësi lejon të zbulohen në lidhje me procedurën e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave mjedisore dhe sociale E&S*).

11.6.3 Ndarja e të dhënave të biodiversitetit

Për të nxitur ndarjen e të dhënave të biodiversitetit dhe në përputhje me synimet ndërkombëtare në lidhje me njohuritë dhe ndarjen e të dhënave të biodiversitetit, Huamarrësi merr përsipër të ndajë, ose të sigurojë se kontraktuesit e tij palë e tretë ndajnë, të dhënat e biodiversitetit (të papërpunuara ose të përpunuara) të gjeneruara në lidhje me Projektin, me bazën e të dhënave botërore te Njësia e Informacionit Global për Biodiversitetin (GBIF), për të mundësuar publikimin e tij.

Për këtë qëllim, Huamarrësi nëpërmjet MIE/ AKUM merr përsipër të marrë të gjitha masat e përshtatshme ndaj kontraktuesve të tij palë e tretë, me qëllim që lejojë ndarjen në bazën e të dhënave botërore të GBIF-së të të dhënave të përpunuara të biodiversitetit mbi të cilën mund të kenë të drejta të pronësisë intelektuale, pavarësisht mjetit.

Ndarja e të dhënave mbi bazën e të dhënave GBIF do të kryhet në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në skedulin 11 (*Ndarja e të dhënave të biodiversitetit*)

AFD-ja do të përmendet si "financuesi i projektit" në seksionin e metadata (të dhëna rreth të dhënave).

11.7 Financimi shtesë

Huamarrësi nuk do të amendojë ose ndryshojë planin e financimit pa marrë pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të marrë financim për çdo kosto shtesë që nuk parashikohet në planin e financimit pjesë e skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje sipas kushteve që sigurojnë që shuma do të shlyhet.

11.8 Klasifikimi *pari passu*

Huamarrësi ndërmerr: i) të garantojë që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje të klasifikohen të paktën në çdo kohë *pari passu* me detyrimet e tjera aktuale dhe të ardhshme të pasiguruara dhe prioritare të pagesës; ii) të mos japë klasifikim ose garanci paraprake huadhënësve të tjerë, përveç nëse të njëjtat klasifikime ose garanci janë dhënë nga Huamarrësi në favor të Huadhënësit, nëse kërkohet nga Huadhënësi.

11.9 Delegimi

Nëse Huadhënësi nuk bie dakord ndryshe me shkrim, Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i caktojë Huadhënësit përfitimin e garancive të Kontraktuesit. Palët duhet të arrijnë në marrëveshje në kohën e duhur mbi rivendosjen e fondeve në Projekt.

11.10 Inspektimet

Me anë të së cilës, Huamarrësi autorizon Huadhënësin dhe përfaqësuesit e tij të kryejnë inspektime, qëllimi i të cilave do të jetë vlerësimi i zbatimit dhe aktiviteteve të Projektit, si dhe ndikimin dhe arritjet e objektivave të Projektit.

Huamarrësi, nëpërmjet MIE/AKUM, sipas rastit duhet të bashkëpunojë dhe t'i ofrojë të gjithë ndihmën dhe informacionin e arsyeshëm Huamarrësit dhe përfaqësuesve të tij kur kryejnë inspektime

të tilla, koha dhe formati i të cilave do të përcaktohen nga Huadhënësi pas konsultimeve me Huamarrësin.

Huamarrësi do të ruajë dhe vendosë në dispozicion për inspektim nga Huadhënësi të gjitha dokumentet në lidhje me shpenzimet e pranueshme për një periudhë prej 10 (dhjetë) vitesh nga data e tërheqjes së fundit të fondit sipas shumës.

11.11 Vlerësimi i Projektit

Huamarrësi pranon që Huadhënësi mund të kryejë ose të sigurojë që një palë e tretë të kryejë në emër të tij, një vlerësim të Projektit. Ky vlerësim do të përdoret për të përgatitur një përmbledhje që përmban informacion mbi Projektin, të tilla si shuma totale dhe kohëzgjatja e financimit, objektivat e Projektit, rezultatet sasiore të pritshme dhe të arritura të Projektit, vlerësimi i rëndësisë, efikasiteti, ndikimi dhe realizueshmëria/qëndrueshmëria e projektit. Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore.

Objektivi kryesor i vlerësimit do të jetë shprehja e një gjykimi të besueshëm dhe të pavarur mbi çështjet kryesore të rëndësisë, zbatimit (efikasitetit) dhe efekteve (efektiviteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria).

Vlerësuesit do të duhet të marrin parasysh në mënyrë të balancuar pikëpamjet e ndryshme legjitime që mund të shprehen dhe të kryejnë vlerësimin në mënyrë të paanshme.

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM sipas rastit do të përfshihet sa më shumë që të jetë e mundur në vlerësim, që nga hartimi i termave të referencës deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.

Huamarrësi pranon publikimin e këtij raporti përfundimtar, veçanërisht në faqen e internetit të Huadhënësit.

11.12 Zbatimi i Projektit

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM, sipas rastit:

i. siguron që çdo person, grup apo subjekt që merr pjesë në zbatimin e Projektit nuk ndodhet i listuar në listën e sanksioneve financiare (duke përfshirë në veçanti luftën kundër financimit të terrorizmit); dhe

ii. nuk financon ndonjë rezervë apo sektorë që janë objekt i një embargo nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Franca.

11.13 Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikat antikonkurruese

Huamarrësi ndërmerr:

i. të sigurojë që fondet, përveç atyre me origjinë shtetërore, të investuara në Projekt nuk do të jenë me origjinë të paligjshme;

ii. të sigurojë nëpërmjet MIE/AKUM sipas rastit që Projekti (veçanërisht gjatë negociatave, hyrja në dhe përmbushja e kontratave të financuara nga shuma) nuk do të shkaktojë ndonjë akt korrupsioni, mashtrim ose praktikë antikonkurruese;

iii. sapo të vihet në dijeni ose të dyshojë për ndonjë akt korrupsioni, mashtrim ose praktikë antikonkurruese, nëpërmjet MIE/AKUM sipas rastit do të informojë Huadhënësin pa vonesë;

iv. në rastin e përmendur në paragrafin "ii" më lart ose me kërkesë të Huadhënësit, nëse Huadhënësi dyshon se aktet/veprimet ose praktikat e përmendura në paragrafin "ii" kanë ndodhur, do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të korrigjuar situatën në një mënyrë të pranueshme për Huadhënësin dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga Huadhënësi; dhe

v. të njoftojë Huadhënësin pa vonesë, nëse ka dijeni për ndonjë informacion që e bën të dyshojë për ndonjë origjinë të paligjshme të fondeve të përdorura për zbatimin e Projektit.

11.14 Vizibiliteti dhe komunikimi

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do të zbatojë veprimet e vizibilitetit dhe komunikimit lidhur me zbatimin e Projektit në përputhje me termat e udhëzuesit të viziblitetit dhe komunikimit të AFD-së dhe pranon se ka lexuar dhe kuptuar plotësisht udhëzuesin e lartpërmendur.

Sipas udhëzuesit të vizibilitetit dhe komunikimit, Projekti është objekt i detyrimeve të komunikimit dhe vizibilitetit të nivelit 1.

11.15 Autorizimet e Projektit

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do të marrë të gjitha autorizimet e Projektit dhe siguron t'i mbajë ato në fuqi dhe efekt të plotë për zbatimin e duhur të Projektit.

12. SIPËRMARRJET E INFORMACIONIT

Sipërmarrjet/angazhimet në këtë klauzolë 12 (*Sipërmarrjet e informacionit*) do të hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë për aq kohë sa ndonjë shumë është e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

12.1 Informacioni financiar

Huamarrësi i siguron Huadhënësit çdo informacion që Huadhënësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me borxhin e jashtëm dhe të brendshëm të Huamarrësit, si dhe statusin e çdo huaje të garantuar.

12.2 Raporti i Progresit

a) Deri në datën e përfundimit teknik, Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i japë Huadhënësit në baza tremujore një raport të progresit teknik dhe financiar në lidhje me zbatimin e Projektit dhe një raport vjetor të ndjekjes së indikatorëve të Projektit në formën e përcaktuar në skedulin 7 (*Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të projektit"*).

b) Brenda 3 (tre) muajve pas datës së përfundimit teknik, Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do t'i japë Huadhënësit një raport të përgjithshëm progresi, duke përfshirë një raport të ndjekjes në lidhje me indikatorët e projektit në formën e përcaktuar në skedulin 7 (*Forma e raportit të ndjekjes së indikatorëve të projektit*).

12.3 Informacioni – të ndryshme

Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM i jep Huadhënësit:

a) menjëherë me marrjen në dijeni të tyre, detajet e çdo rasti ose rrethane që është ose mund të jetë një rast i mospërmbushjes së detyrimeve ose që ka ose mund të ketë një efekt negativ material, natyrën e një rasti të tillë dhe të gjitha veprimet e ndërmarra ose që do të ndërmerren për ta korrigjuar atë (nëse ka);

b) menjëherë me marrjen në dijeni të tyre, detajet e çdo incidenti ose aksidenti që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit, i cili mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në vendin e Projektit, kushtet e punës së punonjësve të tij ose punonjësve të Kontraktuesve, natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë, së bashku me detajet e çdo veprimi të ndërmarrë ose të propozuar për t'u ndërmarrë, sipas rastit, nga Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM për ta korrigjuar atë;

c) menjëherë, detajet e çdo vendimi ose rast që mund të ketë ndikim në organizimin, përfundimin ose funksionimin e Projektit;

d) menjëherë, por në çdo rast, brenda 5 (pesë) ditë pune pas marrjes në dijeni të tyre, detajet e çdo njoftimi të mospërmbushjes së detyrimit, përfundimit, mosmarrëveshjes ose pretendimit material bërë ndaj tij sipas një dokumenti të Projektit ose që prek Projektin, së bashku me detajet e çdo veprimi të ndërmarrë ose të propozuar për t'u ndërmarrë nga Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM për ta korrigjuar atë;]

e) gjatë përfundimit të shërbimeve (përfshirë, por pa u kufizuar në shërbimet që lidhen me studimet dhe monitorimin ku Projekti përfshin ofrimin e këtyre shërbimeve), raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të hartuara nga çdo ofrues shërbimi, dhe pas përfundimit të plotë të shërbimeve të tilla një raport të përgjithshëm të ekzekutimit;

f) sipas rastit, raportet vjetore të AKUM-it, kontratën e performancës dhe indikatorët e rënë dakord nga AKUM-i dhe SHUKD-ja;

g) menjëherë, çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me gjendjen e tij financiare, asetet dhe veprimtaritë ose çdo dokument ose komunikim tjetër të dhënë ose marrë prej tij sipas ndonjë dokumenti të projektit që Huadhënësi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

13. RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE

13.1 Rastet e mospërmbushjes së detyrimeve

Secili prej rasteve ose rrethanave të përcaktuara në këtë klauzolë 13.1 (*Rastet e mospërmbushjes së detyrimeve*) është rast i mospërmbushjes së detyrimeve.

a) Moskryerja e pagesës

Huamarrësi nuk paguan në datën e caktuar ndonjë shumë të pagueshme prej tij sipas kësaj Marrëveshjeje, në mënyrën e kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pa cenuar klauzolën 4.3 (*Pagesa e vonuar dhe kamatëvonesa*), asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve nuk do të ndodhë sipas këtij paragrafi, (a) nëse kjo pagesë është kryer plotësisht nga Huamarrësi brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e kërkuar.

b) Dokumentet e Projektit

Çdo dokument Projekti, ose ndonjë nga të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në të, pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë, i nënshtrohet një njoftimi për përfundimin ose vlefshmëria, ligjshmëria ose zbatueshmëria e tij kundërshtohet.

Asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve nuk do të ndodhë në pajtim me paragrafin "b", nëse: i) kundërshtimi ose njoftimi i përfundimit tërhiqet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas datës në të cilën Huadhënësi e ka informuar Huamarrësin për një kundërshtim ose njoftim të tillë ose Huamarrësi ka marrë dijeni për këtë kundërshtim ose njoftim; dhe ii) sipas opinionit të Huadhënësit, një mosmarrëveshje ose kërkesë e tillë nuk ka pasur një efekt negativ material gjatë periudhës së tillë 30-ditore (tridhjetëditore).

c) Sipërmarrjet dhe detyrimet

Huamarrësi nuk respekton asnjë kusht të Marrëveshjes, duke përfshirë, pa kufizim, cilindo prej sipërmarrjeve/angazhimeve që ka dhënë në pajtim me klauzolën 11 (*Sipërmarrjet*) dhe klauzolën 12 (*Sipërmarrjet e informacionit*).

Me përjashtim të sipërmarrjeve/angazhimeve të dhëna sipas klauzolës 11.6 (*Përgjegjësia mjedisore dhe sociale*), klauzolat 11.12 *(Zbatimi i Projektit)* dhe 11.13 *(Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikat antikonkurruese)* në lidhje me të cilat nuk lejohet asnjë periudhë pa interes, nuk do të ndodhë asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve sipas këtij paragrafi "c" nëse mospërputhja mund të korrigjohet dhe është korrigjuar brenda 5 (pesë) ditësh pune të kohës më të hershme nga: A) data e njoftimit të Huadhënësit ndaj Huamarrësit në lidhje me pamundësinë; dhe B) kur Huamarrësi vihet në dijeni për shkeljen ose brenda afatit kohor të përcaktuar nga Huadhënësi në rastin e përmendur në nënparagrafin "iii" të klauzolës 11.13 (*Origjina e fondeve, moskryerja e akteve të korrupsionit, mashtrimi ose praktikat antikonkurruese*).

d) Keqpërfaqësimi

Një përfaqësim ose garanci e bërë nga Huamarrësi në Marrëveshje, përfshirë sipas klauzolës 10 (*Përfaqësimet dhe garancitë*), ose në ndonjë dokument të dorëzuar nga ose në emër të Huamarrësit sipas ose në lidhje me Marrëveshjen, është i pasaktë ose mashtrues kur është bërë ose konsiderohet se është bërë.

e) Mospërmbushja e tërthortë e detyrimeve

i. në bazë të paragrafit "iii", çdo borxh financiar i Huamarrësit nuk paguhet në datën e caktuar ose, nëse është e zbatueshme, brenda ndonjë periudhe pa interes, të miratuar në përputhje me dokumentacionin përkatës;

ii. një kreditor ka anuluar ose pezulluar angazhimin/detyrimin e tij ndaj Huamarrësit në përputhje me ndonjë borxh financiar ose ka deklaruar borxhin financiar të kërkueshëm dhe të pagueshëm para maturimit të tij të specifikuar, ose ka kërkuar parapagimin e plotë të borxhit financiar, në secilin rast, si rezultat i një rasti të mospërmbushjes së detyrimeve ose ndonjë dispozite që ka ndikim të ngjashëm (në çdo mënyrë që përshkruhet) në përputhje me dokumentacionin përkatës;

iii. asnjë rast i mospërmbushjes së detyrimeve nuk do të ndodhë sipas kësaj klauzole 13.1, (e) nëse shuma përkatëse e borxhit financiar ose angazhimi/detyrimi për borxhin financiar që hyn brenda objektit të paragrafëve "i" dhe "ii" më lart është më pak se tridhjetë milionë euro (EURO 30,000,000) (ose barasvlerën e saj në ndonjë valutë/a tjetër/të tjera).

f) Paligjshmëria

Për Huamarrësin është ose bëhet e paligjshme kryerja e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

g) Ndryshimi material negativ

Çdo rast (duke përfshirë një ndryshim në situatën politike të vendit të Huamarrësit) ose çdo masë që sipas mendimit të Huadhënësit, mund të ketë ndikim material negativ, ndodh ose mund të ndodhë.

h) Tërheqja ose pezullimi i Projektit

Ndodh ndonjë nga rastet e mëposhtme:

i. zbatimi i Projektit pezullohet ose shtyhet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj; ose

ii. Projekti nuk është përfunduar plotësisht deri në datën e përfundimit teknik; ose

iii. Huamarrësi tërhiqet ose pushon pjesëmarrjen në projekt.

i) Autorizimet

Çdo autorizim i kërkuar për Huamarrësin, në mënyrë që të kryejë ose të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose detyrimet e tjera të tij materiale sipas ndonjë dokumenti të Projektit ose i kërkuar në ecurinë e zakonshme të Projektit, nuk është marrë brenda afatit kohor të kërkuar ose është anuluar ose bëhet i pavlefshëm ose ndryshe pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë.

j) Gjykimet ose vendimet që kanë ndikim material negativ.

Çdo gjykim ose vendim arbitrazhi ose çdo vendim gjyqësor ose administrativ që cenon Huamarrësin që sipas mendimit të Huadhënësit, ka ose në mënyrë të arsyeshme mund të ketë ndikim material negativ, ndodh ose mund të ndodhë.

k) Pezullimi i konvertueshmërisë dhe transferimit të lirë

Konvertueshmëria dhe transferimi i lirë i ndonjë prej shumave të kërkueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje, ose ndonjë shume tjetër të dhënë nga Huadhënësi te Huamarrësi ose nga ndonjë huamarrës tjetër i juridiksionit të Huamarrësit, është kundërshtuar.

13.2 Përshpejtimi

Në dhe në çdo kohë pas ndodhisë së një rasti të mospërmbushjes së detyrimeve, huadhënësi, pa dhënë ndonjë kërkesë formale ose pa filluar ndonjë procedurë gjyqësore ose jashtëgjyqësore, duke i dhënë njoftim me shkrim Huamarrësit, mund:

a) të anulojë kredinë në "a" të anulojë kredinë në dispozicion; dhe/ose

b) të deklarojë se e gjithë ose një pjesë e shumës, së bashku me ndonjë interes të shtuar ose të papaguar dhe të gjitha shumat e tjera të papaguara në bazë të kësaj Marrëveshjeje, do të paguhen menjëherë dhe janë të pagueshme.

Pa cenuar sa më sipër, në rast se ndodh një rast i mospërmbushjes së detyrimeve, siç përcaktohet në pikën 13.1 (*Rastet e mospërmbushjes së detyrimeve*), Huadhënësi rezervon të drejtën, duke i dhënë njoftimin me shkrim Huamarrësit: i) të pezullojë ose shtyjë tërheqjen e fondit sipas shumës; dhe/ose ii) të pezullojë finalizimin e çdo marrëveshjeje në lidhje me ofertat e tjera të mundshme financiare që Huadhënësi i ka njoftuar Huamarrësit; dhe/ose iii) të pezullojë ose shtyjë çdo tërheqje fondi sipas ndonjë marrëveshjeje kredie të lidhur midis Huamarrësit dhe Huadhënësit.

13.3. Njoftimi për një rast të mospërmbushjes së detyrimeve

Në përputhje me klauzolën 12.3 (*Informacion),* Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM do të njoftojë menjëherë Huadhënësin pasi të vihet në dijeni për ndonjë rast që është ose ka të ngjarë të jetë një rast i mospërmbushjes së detyrimeve dhe të informojë Huadhënësin për të gjitha masat e parashikuara nga Huamarrësi për ta korrigjuar atë.

14. ADMINISTRIMI I SHUMËS

14.1 Pagesat

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen për pagesën e shpenzimeve, tarifave, interesave, shumave të principalit ose ndonjë shumë tjetër të detyrueshme sipas kësaj marrëveshjeje, sipas renditjes së mëposhtme:

1) kosto dhe shpenzime të rastësishme;
2) tarifa;
3) pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë;
4) interes i shtuar;
5) shlyerjet e principalit.

Çdo pagesë e marrë nga Huamarrësi do të aplikohet së pari në ose për pagimin e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas shumës ose sipas huave të tjera të dhëna nga Huadhënësi ndaj Huamarrësit, nëse është në interesin e Huadhënësit që të aplikojë këto shuma për hua të tjera, sipas renditjes të përcaktuar më lart.

14.2 Kompensimi

Pa miratimin paraprak të Huamarrësit, Huadhënësi, në çdo kohë, mund të kompensojë detyrimet e kërkueshme dhe të pagueshme që përbën detyrim nga Huamarrësi ndaj çdo shume të mbajtur nga Huadhënësi në emër të Huamarrësit ose ndonjë detyrim të kërkueshëm dhe të pagueshëm që Huadhënësi i detyrohet Huamarrësit. Nëse detyrimet janë në valuta të ndryshme, Huadhënësi mund të konvertojë secilin nga detyrimet me kursin e këmbimit mbizotërues të valutës për qëllimin e kompensimit.

Të gjitha pagesat që Huamarrësi bën në bazë të Marrëveshjes do të llogariten dhe bëhen pa

kompensim. Huamarrësi është i ndaluar të bëjë ndonjë kompensim nga pagesat ndaj ndonjë të drejte përveç kur këto të drejta njihen me vendim të formës së prerë.

14.3 Ditët e punës

Pa cenuar llogaritjen e periudhës së interesit që mbetet e pandryshuar, nëse pagesa duhet të bëhet në një ditë që nuk është ditë pune, data e caktuar e kësaj pagese do të jetë dita tjetër e punës, nëse dita tjetër e punës është në të njëjtin muaj kalendarik, ose ditën vijuese të punës nëse dita tjetër e punës nuk është në të njëjtin muaj kalendarik.

14.4 Valuta e pagesës

Valuta e secilës shumë të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje është euro.

14.5 Marrëveshja për numërimin e ditëve

Çdo interes, tarifë ose shpenzim që lind sipas kësaj Marrëveshjeje do të llogaritet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë, në përputhje me praktikën evropiane ndërbankare të tregut.

14.6 Vendi i pagesës

a) Çdo fond që do të transferohet nga Huadhënësi te Huamarrësi në kuadër të shumës në përputhje me klauzolën 3.4 do të paguhet në llogarinë bankare të caktuar posaçërisht për këtë qëllim nga Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM, me kusht që Huadhënësi të ketë dhënë paraprakisht pëlqimin e tij për bankën e zgjedhur. Çdo pagesë që Huamarrësi i bën Huadhënësit do të paguhet në datën e caktuar, jo më vonë se ora 11:00 (ora lokale e Parisit) në llogarinë e mëposhtme bankare:

Kodi RIB: 30001 00064 00000040235 03

Kodi IBAN: FR76 3000 1000 6400 0000 4023 503

Banque de France SWIFT code (BIC): BDFEFRPPCCT

që Huadhënësi ka hapur në Banque de France (selia/dega kryesore) në Paris, ose ndonjë llogari tjetër që Huadhënësi i njofton Huamarrësit.

b) Huamarrësi do të kërkojë nga banka përgjegjëse për transferimin e çdo shume te Huadhënësi, që të japë informacionin e mëposhtëm në çdo mesazh lidhur me transfertat bankare, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në renditjen e përcaktuar si më poshtë:

- principali: emri, adresa, numri i llogarisë bankare;
- banka e principalit: emri dhe adresa;
- referenca: emri i Huamarrësit, emri i Projektit, numri i referencës së Marrëveshjes.

c) Të gjitha pagesat e bëra nga Huamarrësi duhet të jenë në përputhje me këtë klauzolë 14.6 (*Vendi i pagesës*) në mënyrë që detyrimi përkatës i pagesës të konsiderohet i shkarkuar në tërësi.

14.7 Mosfunksionimi i sistemeve të pagesës

Nëse Huadhënësi përcakton (sipas gjykimit të tij) se ka ndodhur një rast i mosfunksionimit të sistemeve të pagesës, ose Huamarrësi njofton Huadhënësin se ka ndodhur një rast i mosfunksionimit të sistemeve të pagesës, Huadhënësi:

a) mund, dhe nëse kërkohet nga Huamarrësi, do të fillojë diskutime me Huamarrësin, me qëllimin për të rënë dakord për çdo ndryshim në funksionimin dhe administrimin e shumës, siç mund të konsiderojë Huadhënësi të nevojshme në rrethana;

b) nuk do të jetë i detyruar të fillojë diskutime me Huamarrësin, në lidhje me ndonjë nga ndryshimet e përmendura në paragrafin "a" më lart, nëse, sipas mendimit të tij, nuk është e praktikueshme të veprojë në këtë mënyrë në rrethanat dhe, në çdo rast, nuk ka asnjë detyrim të pajtohet me ndryshime të tilla; dhe

c) nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë kosto, humbje ose përgjegjësi që lind si rezultat i kryerjes ose mosmarrjes nga ana e tij e ndonjë veprimi, në përputhje me këtë klauzolë 14.7 (*Mosfunksionim i sistemit të pagesës*).

15. TË NDRYSHME

15.1 Gjuha

Gjuha e kësaj marrëveshjeje është gjuha angleze. Nëse kjo marrëveshje përkthehet në një gjuhë tjetër, versioni në anglisht do të ketë përparësi në rast të ndonjë interpretimi konfliktual ose në rast të një mosmarrëveshjeje midis palëve.

Të gjitha njoftimet që jepen ose dokumentet e parashikuara në, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, do të jenë në gjuhën angleze.

Huadhënësi mund të kërkojë që një njoftim ose një dokument i dhënë sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje që nuk është në gjuhën angleze të shoqërohet me një përkthim të certifikuar në anglisht, në këtë rast, përkthimi në anglisht do të ketë përparësi, përveç nëse dokumenti është një dokument ligjor i një shoqërie, tekst juridik ose dokument tjetër zyrtar.

15.2 Certifikimet dhe përcaktimet

Në çdo çështje gjyqësore ose arbitrazhi që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje të dhënat në llogaritë e mbajtura nga Huadhënësi janë provë e qartë (*prima facie)* për çështjet me të cilat ato lidhen.

Çdo certifikim ose përcaktim i bërë nga Huadhënësi për një normë ose shumë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë, në mungesë të një gabimi të qartë, dëshmi përfundimtare e çështjeve me të cilat lidhet.

15.3 Pavlefshmëri e pjesshme

Nëse, në çdo kohë, një term i kësaj marrëveshjeje është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, vlefshmëria, ligjshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikohen ose dëmtohen në asnjë mënyrë.

15.4 Mosheqja dorë

Mosushtrimi ose vonesa për të ushtruar nga ana e Huadhënësit të ndonjë të drejte sipas Marrëveshjes nuk do të konsiderohet si heqje dorë nga kjo e drejtë.

Ushtrimi i pjesshëm i ndonjë të drejte nuk do të pengojë ndonjë ushtrim të mëtejshëm të kësaj të drejte ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjeti tjetër juridik sipas ligjit në fuqi.

Të drejtat dhe mjetet juridike të Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese të të drejtave dhe mjeteve juridike sipas ligjit në fuqi.

15.5 Delegimi

Huamarrësi nuk mund të delegojë ose transferojë, në asnjë mënyrë, çfarëdo qoftë, të gjitha ose ndonjë nga të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huadhënësi mund të caktojë ose transferojë ndonjë prej të drejtave ose detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje te: i) ndonjë filial ose subjekt i të njëjtit grup si Huadhënësi; ose ii) ndonjë institucion tjetër financiar; ose iii) subjekt tjetër, me kusht që të ketë qenë e themeluar, me vendbanim apo e krijuar në Bashkimin Evropian dhe mund të hyjë në ndonjë marrëveshje nënpjesëmarrjeje që lidhet me të.

Huadhënësi do t'i japë informacion paraprak Huamarrësit për këtë delegim apo transferim.

15.6 Efekti ligjor

Skedulet e aneksuara në këtë marrëveshje, udhëzimet e prokurimit dhe pikat e saj janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe kanë të njëjtin efekt juridik.

15.7 Marrëveshja e plotë

Në datën e nënshkrimit, kjo Marrëveshje përfaqëson të gjithë marrëveshjen midis Palëve, në lidhje me çështjet e përcaktuara këtu dhe tejkalon dhe zëvendëson të gjithë dokumentet, marrëveshjet ose kuptimet e mëparshme, të cilat mund të jenë shkëmbyer ose komunikuar si pjesë e negociatave në lidhje me këtë Marrëveshje.

15.8 Amendimet

Çdo Amendim në këtë Marrëveshje do të bëhet me shkrim.

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton, se:

i. ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo amendament, që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave; dhe

ii. amendimet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë në periudhën e disponibilitetit nuk kërkojnë miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

15.9 Konfidencialiteti – zbulimi i informacionit

a) Huamarrësi nuk do ta zbulojë përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje te ndonjë palë e tretë pa pëlqimin paraprak të Huadhënësit, përveç te ndonjë person, ndaj të cilit Huamarrësi ka detyrimin e zbulimit, sipas ndonjë ligji të zbatueshëm, rregulloreje apo vendimi gjyqësor. Huamarrësi mund të publikojë këtë Marrëveshje në gazetën zyrtare nëse kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm dhe aktet nënligjore për efektshmërinë e Marrëveshjes.

b) Pavarësisht nga ndonjë marrëveshje ekzistuese e konfidencialitetit, Huadhënësi mund të zbulojë çdo informacion ose dokument në lidhje me Projektin te: i) auditorët, ekspertët, agjencitë e klasifikimit, këshilltarët ligjorë ose organet e tij mbikëqyrëse; ii) çdo person ose ent të cilit Huadhënësi mund t'i

caktojë ose transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave ose detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes; dhe iii) çdo person ose ent për qëllimin e marrjes së masave mbrojtëse ose ruajtjen e të drejtave të Huadhënësit sipas Marrëveshjes.

c) Gjithashtu, Huadhënësi mund të komunikojë dhe zbulojë në faqen e internetit të Huadhënësit informacion në lidhje me Projektin dhe financimin e tij, siç janë listuar në skedulin 8 (*Informacioni për të cilin Huadhënësi është i autorizuar shprehimisht të zbulojë në faqen e internetit të Huadhënësit (në veçanti në platformën e tij të hapur të të dhënave).*

15.10 Kufizimi

Parashkrimi i çdo pretendimi në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të jetë 10 (dhjetë) vjet, përveç ndonjë pretendimi për interes për shkak të kësaj Marrëveshjeje.

15.11 Shtrëngimi

Secila Palë pranon se dispozitat e nenit 1195 të Kodit Civil Francez nuk zbatohen për të në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes dhe nuk do të ketë të drejtë të bëjë ndonjë pretendim sipas nenit 1195 të Kodit Civil Francez.

16. NJOFTIMET

16.1 Me shkrim dhe adresat

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër që duhet të jepet ose bëhet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jepet ose bëhet me shkrim dhe, përveç nëse përcaktohet ndryshe, mund të jepet ose bëhet me faks ose me letër të dërguar nga zyra postare në adresën dhe numrin e Palës përkatëse, të përcaktuar më poshtë:

Për Huamarrësin:
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Adresa: bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Telefoni: 00 35 54 22 84 05
Faksi: sekretariamin@financa.gov.al
Në vëmendje të: ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Për Huadhënësin:
AFD – ZYRA RAJONALE E BALLKANIT PERËNDIMOR
Adresa: bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Twin Tours, Tour 2, 7th Floor
Telefon: +381 11 78 58 830
Faks: +381 11 78 58 830
Në vëmendje të: afdbalkans@fd.fr
Në vëmendje të: Dominique HAUTBERGUE, drejtor i Zyrës Rajonale për Ballkanin Perëndimor.
Kopje për:
AFD – PARIS ZYRA QENDRORE
Adresa: 5, rue Roland Barthes – 75598 Paris Cedex 12, France
Telefon : + 33 1 53 44 31 31
Në vëmendje të: përgjegjës i Departamentit për Evropën, Lindjen e Mesme dhe Azinë

ose në ndonjë adresë, postë elektronike, departament ose zyrtar tjetër, që Palët i njoftojnë njëra tjetrës.

16.2 Dorëzimi

Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim që bëhet ose çfarëdo dokumenti që Palët i dërgojnë njëra tjetrës në lidhje me këtë Marrëveshje do të jetë efektive vetëm nëse :

a) kur dërgohet me e-mail (postë elektronike), merret në një formë të pranueshme; dhe

b) kur dërgohet me letër nëpërmjet zyrës postare, dorëzohet në adresën e saktë,

dhe, kur një person ose një departament i caktuar specifikohet si pjesë e detajeve të adresës të parashikuara në klauzolën 16.1 (*Me shkrim dhe adresat*), nëse një njoftim, kërkesë ose komunikim i tillë i është drejtuar atij personi ose departamenti.

Komunikimet elektronike

a) Çdo komunikim që një person i dërgon një personi tjetër sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje,

mund të bëhet me postë elektronike ose mjete të tjera elektronike, nëse Palët:

i. bien dakord që, përveç nëse dhe derisa të njoftohet për të kundërtën, kjo do të jetë një formë e pranuar e komunikimit;

ii. njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për adresën e tyre të postës elektronike dhe/ose çdo informacion tjetër që kërkohet për të mundësuar dërgimin dhe pranimin e informacionit me atë mjet; dhe

iii. njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të adresës së tyre ose ndonjë informacion tjetër që Palët japin.

f) Çdo komunikim elektronik ndërmjet Palëve do të jetë efektiv vetëm kur merret në një formë të lexueshme.

17. LIGJI RREGULLUES, ZBATIMI DHE ZGJEDHJA E VENDBANIMIT

17.1 Ligji rregullues

Kjo marrëveshje rregullohet nga legjislacioni francez

17.2 Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të referohet dhe zgjidhet përfundimisht me anë të arbitrazhit, sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, të zbatueshme në datën e fillimit të procedurave të arbitrazhit, nga një ose më shumë arbitra që duhet të emërohen në përputhje me rregulla të tilla.

Selia e arbitrazhit do të jetë në Paris dhe gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

Kjo klauzolë arbitrazhi do të mbetet në fuqi dhe efekt të plotë nëse kjo Marrëveshje shpallet e pavlefshme ose përfundohet ose anulohet dhe pas skadimit të kësaj Marrëveshjeje. Detyrimet kontraktuale të Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje nuk pezullohen nëse një Palë fillon procedura ligjore kundër Palës tjetër.

Palët bien dakord shprehimisht se, me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga të gjitha të drejtat e imunitetit, në lidhje me juridiksionin ose ekzekutimin mbi të cilin mund të mbështetet ndryshe.

Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje, me:

i. "ambientet e misionit" të tanishme ose në të ardhmen, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, "ambientet konsullore" të tashme ose në të ardhmen, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar në vitin 1963, ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose ndonjë agjenci ose instrumentalitet me funksion diplomatik;

ii. çdo pronë e paluajtshme me vendndodhje në Shqipëri, që bie sipas nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, të datës 22.2.2001, "Për pasuritë e paluajtshme";

iii. çdo fond monetar dhe/ose shumë të kërkueshme për t'u paguar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve publike ndërkombëtare të nënshkruara nga ajo në cilësinë e saj si subjekt i të drejtës publike ndërkombëtare.

17.3 Njoftimi i procesit

Pa cenuar ndonjë ligj të zbatueshëm, për qëllime të njoftimit të dokumenteve gjyqësore dhe ekstragjyqësore në lidhje me ndonjë veprim ose procedurë të përmendur më lart.

Njoftimi i dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore për Huamarrësin do të bëhet në përputhje me Konventën e Hagës, të vitit 15 nëntor 1965, për njoftimin jashtë vendit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe tregtare. Autoriteti caktues për këtë njoftim është Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë, me adresë: bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 6, Tiranë, Shqipëri.

Huamarrësi zgjedh adresën "AFD-PARIS HEAD OFFICE", të përcaktuar në pikën 16 (*Njoftimet*) për njoftimin e procesit.

18. KOHËZGJATJA

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi dhe efekt të plotë për aq kohë sa çdo shumë është e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Pavarësisht nga sa më lart, detyrimet sipas klauzolave 12.3 (e) (*Informacioni – të ndryshme*) dhe 15.9 (*Konfidencialiteti – zbulimi i informacionit*) do të mbijetojnë dhe mbesin në fuqi dhe efekt të plotë për një periudhë prej pesë vjet pas datës së fundit të pagesës; dispozitat e klauzolës 11.6.2 (*Menaxhimi i ankesave*

mjedisore dhe sociale (E&S)) do të vazhdojnë të kenë efekt ndërsa çdo ankesë e paraqitur në procedurën e punës së mekanizmit të ankesave ES ende po përpunohet ose monitorohet.

Ekzekutuar në 2 (dy) origjinale, 1 (një) për Huadhënësin dhe 1 (një) për Huamarrësin, në Tiranë (Republika e Shqipërisë), më 15 nëntor 2022.

HUAMARRËSI
KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

/nënshkrimi/

_____

Përfaqësuar nga:

Shkëlqesia e Saj, znj. Delina IBRAHIMAJ
Funksioni: Ministre e Financave dhe Ekonomisë

HUADHËNËSI
AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT
/nënshkrimi/

_____

Përfaqësuar nga:
Emri: znj. Cécile COUPRIE
Funksioni: drejtore rajonale për Euroazinë

Bashkënënshkruese, Shkëlqesia e Saj, znj. Laurence BOONE, ministre e Shtetit për Evropën, Republika Franceze

SKEDULI 1/A. PËRKUFIZIMET

Akti i korrupsionit	nënkupton ndonjë nga sa më poshtë vijon: a) akti i premtimit, ofrimit ose dhënies, drejtpërdrejti ose jodrejtpërsëdrejti, te një zyrtar publik ose cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, për një ent të sektorit privat, një avantazh të padrejtë të çdo natyre, për vetë personin përkatës ose për një person ose ent tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në kundërshtim me detyrimet e tij ligjore, kontraktuale ose profesionale dhe, duke pasur efekt të ndikojë në veprimet e tij ose të saj ose të një personi ose enti tjetër; ose b) akti i një Zyrtari Publik ose i ndonjë personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, për një ent të sektorit privat, duke kërkuar ose pranuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një avantazh të padrejtë të çdo natyre, për vetë personin përkatës ose për një person ose ent tjetër, në mënyrë që ky person të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në kundërshtim me detyrimet e tij ligjore, kontraktuale ose profesionale dhe, duke pasur efekt të ndikojë në veprimet e tij ose të saj ose të një personi ose enti tjetër.
Marrëveshje	nënkupton këtë marrëveshje për shumën e kredisë, duke përfshirë pikat e saj, skedulet dhe, nëse është e zbatueshme, çdo ndryshim të bërë me shkrim në marrëveshje.
Praktikat antikonkurruese	nënkupton: a) çdo veprim të bashkërenduar ose të nënkuptuar që ka si objekt të tij dhe/ose efekte të tij për të penguar, kufizuar ose shtrembëruar konkurrencën e ndershme në një treg, duke përfshirë pa kufizime kur synon, të: i) kufizojë aksesin në treg ose ushtrimin e lirë të konkurrencës nga kompani të tjera; ii) parandalojë vendosjen e çmimeve nga loja e lirë e tregjeve duke favorizuar artificialisht rritjen ose uljen e çmimeve të tilla; iii) kufizojë ose kontrollojë çdo prodhim, treg, investim ose përparim teknik; ose iv) ndajë tregjet ose burimet e furnizimit; b) çdo abuzim nga një shoqëri ose grup shoqërish me një pozitë mbizotëruese në tregun e brendshëm ose në një pjesë të konsiderueshme të tij; ose g) çdo çmim oferte ose e ulur që ka si objekt dhe/ose efektin e tij për të eliminuar nga një treg, ose për të parandaluar që një shoqëri ose një prej produkteve të saj të hyjë në treg.
Autorizimi/et	nënkupton çdo autorizim, pëlqim, aprovim, zgjidhje, leje, licencë, përjashtim, paraqitje, noterizim ose regjistrim, ose ndonjë përjashtim në lidhje me të, të marrë nga ose siguruar nga një autoritet, i dhënë me anë të një akti, ose i konsideruar i dhënë nëse përgjigja nuk merret brenda një afati të caktuar kohor.
Autoritet (Autoritete)	nënkupton çdo qeveri ose ent statutor, departament ose komision që ushtron një prerogativë publike, ose çdo administratë, gjykatë, agjenci ose shtet ose ndonjë ent qeveritar, administrativ, tatimor ose gjyqësor.
Periudha e	nënkupton periudhën nga dhe duke përfshirë datën e nënshkrimit deri në afatin për tërheqjen e fondit.

disponibilitetit	
Kredia e disponueshme	nënkupton, në çdo kohë të caktuar, shumën maksimale të principalit të specifikuar në klauzolën 2.1 (*Shuma*) minus: i. shumën e përgjithshme të çdo tërheqje fondi të transferuar nga Huamarrësi; ii. shumën e çdo tërheqjeje fondi që duhet të bëhet në bazë të ndonjë kërkese për tërheqje fondi; dhe iii. çdo pjesë e shumës që është anuluar në pajtim me klauzolat 8.3 (*Anulimi nga Huamarrësi*) dhe/ose 8.4 (*Anulimi nga Huadhënësi*).
Ditë pune	nënkupton një ditë (përveç ditës së shtunë ose të diel) kur bankat janë të hapura gjatë gjithë ditës për biznes të përgjithshëm në Paris, dhe që është një ditë TARGET, në rast se në atë ditë duhet të bëhet një tërheqje fondi.
Vërtetuar	nënkupton për çdo kopje, fotokopje ose kopjim tjetër të një dokumenti origjinal, vërtetim nga çdo person i autorizuar sipas rregullave, në lidhje me përputhshmërinë e kopjes, fotokopjes ose kopjimit me dokumentin origjinal.
Kontraktues (Kontraktuesit)	nënkupton Kontraktuesin/ët palë e tretë të ngarkuar për zbatimin e të gjithë ose një pjesë të Projektit, në zbatim të dokumenteve të Projektit.
Garancia/të e Kontraktuesit	nënkupton çdo garanci që i jepet Huamarrësit nëpërmjet MIE/AKUM drejtpërdrejt ose tërthorazi nga çdo Kontraktues i ngarkuar për përfundimin e Projektit ose të ndonjë pjese të tij, të tilla si, për shembull, garancia e përfundimit ose garancia e paradhënies.
Afati për tërheqjen e fondit	nënkupton datën 15 nëntor 2027, datën pas së cilës nuk mund të kryhet asnjë tërheqje e mëtejshme fondi.
Tërheqje fondi	nënkupton një tërheqje fondi të të gjithë ose një pjese të shumës të bërë ose që duhet të bëhet, të vënë në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në klauzolën 3 (*Tërheqja e fondeve*) ose shuma principal e papaguar e këtij tërheqje fondi, e cila mbetet e kërkueshme dhe e pagueshme në një kohë të caktuar.
Data e tërheqjes së fondit	nënkupton datën kur një tërheqje fondi është vënë në dispozicion nga Huadhënësi.
Periudha e tërheqjes së fondit	nënkupton periudhën që fillon në datën e parë të tërheqjes së fondit deri dhe përfshirë edhe datës vijuese: i) datën kur kredia e disponueshme është e barasvlershme me zero; ii) datën e transferimit të fondit
Kërkesa për tërheqjen e fondit	nënkupton një kërkesë kryesisht në formën e paraqitur në skedulin 5A (*Forma e kërkesës për tërheqje fondi*).
Embargoja	nënkupton çdo sanksion i një natyre tregtare, që synon të ndalojë çdo import dhe/ose eksport (furnizim, shitje ose transferim) të një ose disa mallrave, produkteve ose shërbimeve që shkojnë në dhe/ose që vijnë nga një vend për një periudhë të caktuar, siç publikohet dhe ndryshohet herë pas here nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Franca.
Data e hyrjes në fuqi	nënkupton datën pas 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të ligjit që ratifikon këtë Marrëveshje
Procedura e punës së mekanizmit të menaxhimit të ankesave ES	nënkupton termat kontraktualë të përfshir në procedurën e punës së mekanizmit të ankesave mjedisore dhe sociale, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit, të ndryshuara herë pas here.
ESCP	nënkupton planin e angazhimit mjedisor dhe social të bashkangjitur më poshtë si Shtojca 6, ku përcaktohet angazhimi i Huamarrësit për të shmangur, zbutur ose kompensuar pasojat negative të Projektit, në mjedisin njerëzor dhe natyror dhe çdo monitorim të planifikuar, si dhe hapat formalë që kërkohen për të kryer veprime të tilla.
EURIBOR	nënkupton normën e ofruar ndërbankare të zbatueshme për euron për çdo depozitë të shprehur në euro, për një periudhë të krahasueshme me periudhën përkatëse, siç përcaktohet nga Instituti Evropian i Tregjeve Monetare (EMMI), ose ndonjë pasardhës i tij, në orën 11:00 të mëngjesit të orës lokale të Brukselit, 2 (dy) ditë pune përpara ditës së parë të periudhës së interesit.
Euro (s) ose EUR	nënkupton valutën e vetme të shteteve anëtare të Unionit Ekonomik dhe Monetar Evropian, duke përfshirë Francën, dhe që kanë kurs ligjor në këto Shtete Anëtare.
Rast i mospërmbushjes së detyrimeve	nënkupton çdo rast ose rrethanë të përcaktuar në pikën 13.1 (*Rast i mospërmbushjes së detyrimit*).
Shuma	nënkupton shumën e kredisë të vënë në dispozicion nga Huadhënësi për Huamarrësin, në përputhje me këtë Marrëveshje deri në shumën maksimale kryesore të përcaktuar në klauzolën 2.1 *(Shuma*).
Borxh financiar	nënkupton çdo borxh financiar për dhe në lidhje me: a) çdo para të marrë hua mbi një bazë afatshkurtër, afatmesëm ose afatgjatë; b) shumat e mbledhura në bazë të emetimit të bonove, notave, borxheve, stokut të huas ose ndonjë instrumenti të ngjashëm; c) çdo fond i mbledhur sipas ndonjë transaksioni tjetër (përfshirë çdo marrëveshje shitblerjeje) që ka efektin tregtar të një huamarrjeje;

	d) çdo detyrim i mundshëm i pagesës që rrjedh nga një garanci, obligacion ose ndonjë instrument tjetër.
Lista e sanksioneve financiare	nënkupton listën/at e personave, grupeve ose subjekteve që i nënshtrohen sanksioneve financiare nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe/ose Franca. Vetëm për qëllime informacioni dhe për lehtësinë e Huamarrësit, i cili mund të mbështetet në referencat ose adresat e internetit në vijim: *Për listat e mbajtura nga Kombet e Bashkuara*, mund të shihni faqen e mëposhtme të internetit: https://www.un.org/securitycouncil/fr/content/un-sc-consolidated-list *Për listat e mbajtura nga Bashkimi Evropian*, mund të shikoni faqen e mëposhtme të internetit: https://eeas.Europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_fr *Për listat e mbajtura nga Franca*, mund të shihni faqen e mëposhtme të internetit: https://www.tresor.economie.gouv.fr/services-auxentreprises/sanctions-economiques/dispositif-national-de-gel-desavoirs
Plani i financimit	nënkupton planin e financimit të Projektit të përcaktuar në shtojcën 3 (*Plani i financimit*).
Norma fikse e referencës	nënkupton katër pikë pesëdhjetë e gjashtë për qind (4.56%) në vit.
Mashtrim	nënkupton çdo praktikë të padrejtë (veprime ose mosveprime) të qëllimshme për të mashtruar të tjerët, për të fshehur me dashje elemente, ose për të tradhtuar ose përligjur pëlqimin e tij/saj, për të shmangur çdo kërkesë ligjore ose rregullatore dhe/ose për të shkelur rregullat dhe procedurat e brendshme të Huamarrësit ose një pale të tretë për të marrë një përfitim të paligjshëm.
Mashtrimi ndaj interesave financiare të Komunitetit Evropian	nënkupton çdo veprim ose mosveprim të qëllimshëm të synuar për të dëmtuar buxhetin e Bashkimit Evropian dhe që përfshin: i) përdorimin ose prezantimin e deklaratave ose dokumenteve të rreme, të pasakta ose të paplota, i cili ka si efekt shpërdorimin ose mbajtjen e gabuar të fondeve ose ndonjë reduktim të paligjshëm të burimeve të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Evropian; ii) moszbulimi i informacionit me të njëjtin efekt; dhe iii) shpërdorimi i fondeve të tilla për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat këto fonde ishin dhënë fillimisht.
Periudha pa Interes	nënkupton periudhën nga data e nënshkrimit deri dhe duke përfshirë edhe datën që përkon me gjashtë muaj pas kësaj date, gjatë së cilës asnjë shlyerje e principalit sipas Shumës nuk është e kërkueshme dhe e pagueshme.
Origjina e Paligjshme	nënkupton fondet e marra përmes: a) Kryerjes së ndonjë vepre atribut siç përcaktohet në Fjalorin e Rekomandimeve të FATF 40 sipas "*Kategorive të përcaktuara të veprave penale*" (http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/Recommandations_GAFI.pdf); b) çdo akt i korrupsionit; ose c) çdo mashtrim ndaj interesave financiare të Komunitetit Evropian, nëse ose kur është e zbatueshme
Norma e Indeksit	nënkupton indeksin ditor të TEC 10, normën e maturimit të vazhdueshëm dhjetëvjeçar të shfaqur çdo ditë në faqen përkatëse të kuotimit të Institucionit Financiar të Referencës ose ndonjë indeksi tjetër që mund të zëvendësojë indeksin ditor të TEC 10. Në datën e nënshkrimit, norma e indeksit më 4 nëntor 2022 është dy pikë e shtatëdhjetë e shtatë për qind (2.77%) në vit.
Deklarata e Integritetit	nënkupton integritetin, përshtatshmërinë dhe deklaratën e sipërmarrjes mjedisore dhe sociale, në formën e përcaktuar në skedulet e udhëzimeve të prokurimit që çdo tenderues ose kandidat do të dorëzojë në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikën 1.2.3 të udhëzimeve.
Periudha/t e interesit	nënkupton secilën periudhë nga data e pagesës (përjashtuar) deri në datën tjetër të pagesës (përfshirë). Për çdo tërheqje fondi sipas shumës, periudha e parë e interesit do të fillojë në datën e tërheqjes së fondit (përjashtuar) dhe do të përfundojë në datën tjetër vijuese të pagesës (përfshirë).
Norma e interesit	nënkupton normën e interesit të shprehur si përqindje dhe e përcaktuar në përputhje me klauzolës 4.1 (*Norma e interesit*).
Ligjet e Republikës së Shqipërisë	nënkupton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe çdo akt normativ të zbatueshëm, siç përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë, por pa kufizuar çdo akt qeveritar kombëtar ose lokal, urdhër, dekret dhe çdo ligj ose rregullore tjetër e Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe efekt në çdo kohë dhe e ndryshuar herë pas here për sa kohë që kjo Marrëveshje zbatohet.
Marzh	Nënkupton 1.45% (një pikë e dyzet e pesë për qind) në vit.
Rast i mosfunksionimit të tregut	nënkupton kur ndodh një prej ngjarjeve të mëposhtme: i) EURIBOR nuk përcaktohet nga Instituti Evropian i Tregjeve Monetare (EMMI), ose ndonjë administrator pasardhës, në orën 11:00 të mëngjesit me orën lokale të Brukselit, 2 (dy) ditë pune para ditës së parë të periudhës përkatëse të interesit ose në datën e përcaktimit të normës; ose ii) para mbylljes së biznesit të tregut ndërbankar evropian, dy (2) ditë pune para ditës së parë të periudhës përkatëse të interesit ose në datën e përcaktimit të normës, Huamarrësi merr njoftim nga Huadhënësi, se: i) kostoja për Huadhënësin për marrjen e burimeve që përputhen në tregun ndërbankar përkatës do të ishte më e madhe se EURIBOR për periudhën përkatëse të interesit; ose ii) nuk mund ose nuk do të mund të marrë burime që përputhen në tregun ndërbankar përkatës në ecurinë e zakonshme të biznesit për të financuar tërheqjen përkatëse të fondit për periudhën përkatëse kohore.
Efekt material	nënkupton një efekt material dhe negativ mbi:

negativ	a) Projektin, në masën që do të rrezikonte zbatimin dhe funksionimin e Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje dhe dokumentet e Projektit; b) biznesin, asetet, gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshje dhe dokumenteve të Projektit; c) vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshje dhe ndonjë dokumenti të Projektit; d) ndonjë të drejtë ose mjet juridik i Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshje
Principal i papaguar	nënkupton, në lidhje me ndonjë tërheqje fondi, shumën e papaguar të principalit të kërkueshëm për sa i përket një tërheqje të tillë fondi, që korrespondon me shumën e tërheqjes së fondit që Huadhënësi i ka paguar Huamarrësit, më pak se shuma totale e kësteve të principalit të ripaguar nga Huamarrësi për Huadhënësin, në lidhje me një tërheqje të tillë fondi.
Datat e pagesës	nënkupton datën 30 prill dhe 31 tetor të çdo viti
Rast i mosfunksionimit të sistemeve të pagesave	nënkupton njërën ose të dyja sa vijon: a) një mosfunksionim material në sistemet e pagesave ose të komunikimit ose në tregjet financiare, të cilat, në secilin rast, duhet të operojnë në mënyrë që pagesat të bëhen në lidhje me shumën (ose ndryshe, në mënyrë që të kryhen transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje), me kusht që mosfunksionimi të mos jetë shkaktuar nga, dhe është përtej kontrollit të ndonjë prej Palëve; ose b) ndodh ndonjë rast tjetër që rezulton në mosfunksionim (të një natyre teknike ose të lidhur me sistemin) për aktivitetet e thesarit ose të pagesave të një Pale që e parandalon atë, ose ndonjë Palë tjetër: i. nga përmbushja e detyrimeve të saj të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje; ose ii. nga komunikimi me Palët e tjera në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe e cila (në secilin rast) nuk shkaktohet nga, dhe është përtej kontrollit të secilës Palë.
Dëmshpërblimi kompensues i parapagimit	nënkupton dëmshpërblimin e llogaritur duke aplikuar përqindjen e mëposhtme për sasinë e shumës që është paguar paraprakisht: - nëse shlyerja ndodh përpara përvjetorit të 5-të (përjashtues) të datës së nënshkrimit: dy pikë pesë për qind (2.5 %); - nëse shlyerja ndodh midis përvjetorit të 5-të (përfshirës) dhe përvjetorit të 10-të (përjashtues) të datës së nënshkrimit: një pikë pesë për qind (1.5%); - nëse shlyerja ndodh midis përvjetorit të 10-të (përfshirës) dhe përvjetorit të 15-të (përjashtues) të datës së nënshkrimit: një për qind (1 %); - nëse shlyerja ndodh pas përvjetorit të 15-të (përfshirës): të datës së nënshkrimit: zero pikë pesë për qind (0.5 %);
Udhëzimet e prokurimit	nënkupton dispozitat kontraktuale të përfshira në udhëzimet në lidhje me prokurimin e financuar nga AFD-ja në vendet e huaja, të datës shkurt 2019, një kopje e të cilit i është dorëzuar Huamarrësit nëpërmjet MIE/AKUM. Udhëzimet e prokurimit janë të disponueshme në faqen e internetit të Huadhënësit.
Projekti	nënkupton Projektin siç përshkruhet në shtojcën 2 (*Përshkrimi i Projektit*).
Autorizimet e Projektit	nënkupton autorizimet e nevojshme në mënyrë, që: i) Huamarrësi të zbatojë Projektin dhe të ekzekutojë të gjitha dokumentet e Projektit në të cilat është palë, dhe të ushtrojë të drejtat e tij dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas dokumenteve të Projektit ku është palë; dhe ii) dokumentet e Projektit në të cilat Huamarrësi është palë, të jenë të pranueshme si prova para gjykatave në juridiksionin e Huamarrësit ose përpara një tribunali kompetent të arbitrazhit.
Dokumentet e Projektit	nënkupton të gjitha dokumentet, dhe në veçanti marrëveshjet, të dorëzuara ose të ekzekutuara nga Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM në lidhje me zbatimin e Projektit, d.m.th.: Marrëveshja për zbatimin e projektit e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shërbimit të Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës; - Manuali i aktiviteteve të projektit; - Raportet tremujore të zbatimit të projektit; - ESCP; - Rezultatet e projektit, duke përfshirë studimet e fizibilitetit, projektet paraprake dhe të detajuara, dokumentet e tenderit, raportet e vlerësimit të ofertës, kontratat e nënshkruara, raportet e ndërmjetme dhe përfundimtare të kontraktuesve të projektit;
Zyrtar publik	nënkupton çdo mbajtës të funksionit legjislativ, ekzekutiv, administrativ ose gjyqësor, i emëruar ose zgjedhur, që shërben mbi baza të përhershme ose ndryshe, i paguar ose i papaguar, pavarësisht nga grada, ose çdo person tjetër i përcaktuar si zyrtar publik në bazë të legjislacionit Republikës së Shqipërisë, dhe çdo person tjetër që ushtron një funksion publik, duke përfshirë një agjenci ose organizatë publike ose duke siguruar një shërbim publik.
Konvertimi i normës	nënkupton konvertimin e normës luhatëse të zbatueshme për të gjithë ose një pjesë të Shumës në një normë fikse, në përputhje me klauzolën 4.1 (*Norma e interesit*).
Kërkesë për konvertimin e normës	nënkupton një kërkesë nga Huamarrësi në thelb në formën e bashkangjitur si skeduli 5C (*Forma e kërkesës për konvertimin e normës*).
Data e vendosjes së normës	nënkupton: I. në lidhje me çdo periudhë interesi për të cilën duhet të përcaktohet një normë interesi: i. të mërkurën e parë (ose nëse kjo datë nuk është një ditë pune, dita vijuese e punës) pas datës së

	marrjes nga Huadhënësi të kërkesës për tërheqje fondi, me kusht që kërkesa për tërheqje fondi të merret nga Huadhënësi të paktën 2 (dy) ditë të plota pune përpara ditës së mërkurë; ii. e mërkura e dytë (ose, nëse kjo datë nuk është një ditë pune, menjëherë dita vijuese e punës) pas datës së marrjes nga Huadhënësi të kërkesës për tërheqje fondi, nëse kërkesa për tërheqje fondi nuk është marrë nga Huadhënësi të paktën 2 (dy) ditë të plota pune përpara të mërkurës së parë të specifikuar në paragrafin "a" më lart: II. në rastin e një konvertimi të normës: i. e mërkura e parë (ose nëse kjo datë nuk është një ditë pune, menjëherë dita vijuese e punës) pas datës së marrjes nga Huadhënësi të kërkesës për konvertim të normës, me kusht që kjo datë është të paktën 2 (dy) ditë të plota pune përpara të mërkurës së parë; ii. e mërkura e dytë (ose nëse kjo datë nuk është një ditë pune, menjëherë dita vijuese e punës) pas datës së marrjes nga Huadhënësi të kërkesës për konvertim të normës, nëse kjo datë nuk është të paktën 2 (dy) ditë të plota pune përpara të mërkurës së parë.
Institut financiar i referencës	nënkupton një institucion financiar të zgjedhur nga Huadhënësi si një institucion financiar të referencës i përshtatshëm dhe i cili boton rregullisht citime të instrumenteve financiare në një nga rrjetet ndërkombëtare të informacionit financiar, sipas praktikave të njohura nga industria bankare.
Skeduli/et	nënkupton çdo skedul ose skedule të kësaj Marrëveshjeje.
Data e nënshkrimit	nënkupton datën e fundit nga dy datat e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje.
Dita TARGET	nënkupton një ditë kur Sistemi Automatik Transevropian i Transferimit Ekspres të Shlyerjes Bruto në Kohë Reale 2 (TARGET 2) ose ndonjë pasues i tij është i hapur për shlyerjen e pagesave në Euro.
Taksa/at	nënkupton çdo taksë, taksë tatimore, tarifë doganore, tatim ose detyrim tjetër ose mbajtje të një natyre të ngjashme (përfshirë çdo penalitet ose interes të pagueshëm në lidhje me një mospagim ose ndonjë vonesë në pagimin e shumave të tilla).
Data e përfundimit teknik	nënkupton datën e përfundimit teknik të Projektit, e cila pritet të jetë data 31 dhjetor 2026.
Udhëzuesi i vizibilitetit dhe komunikimit	Nënkupton të gjitha dispozitat kontraktuale detyruese për Huamarrësin në lidhje me projektet e komunikimit dhe vizibilitetit të financuara nga AFD-ja dhe që përfshihen në dokumentin e emërtuar "Udhëzuesi i vizibilitetit për projektet e mbështetura nga AFD-ja- niveli 1" ose "Udhëzuesi i komunikimit për projektet e mbështetura nga AFD-ja- niveli 2" sipas rastit, një kopje e të cilës i është dhënë Huamarrësit përpara nënshkrimit.
Faqja e internetit	nënkupton faqen e internetit të AFD-së (http://www.afd.fr/) ose ndonjë faqe tjetër të tillë interneti zëvendësuese.
Tatim mbi burim	nënkupton çdo zbritje ose mbajtje në lidhje me një taksë mbi çdo pagesë të bërë sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

SKEDULI 1/B. INTERPRETIMI

a) "**asetet**" përfshijnë pronat e tashme dhe të ardhshme, të ardhurat dhe të drejtat e çdo përshkrimi;

b) çdo referencë për "Huamarrësin", "Palën" ose "Huadhënësin" përfshin pasardhësit e tij në titull, delegimet e lejuara dhe transferimet e lejuara;

c) çdo referencë në një Marrëveshje ose dokument tjetër është një referencë në këtë Marrëveshje ose në një dokument tjetër të ndryshuar, përsëritur ose plotësuar dhe përfshin, nëse është e zbatueshme, çdo dokument që e zëvendëson atë përmes novacionit, në përputhje me Marrëveshjen;

d) një "**garanci**" përfshin *çdo depozitë*, *angazhim* dhe *çdo garanci,* që është e pavarur nga borxhi me të cilin ka të bëjë;

e) "**borxhi**" nënkupton çdo detyrim të cilitdo personi cilado qoftë (pavarësisht nëse është bërë si principal ose si garanci) për pagesën ose shlyerjen e parave, qoftë kjo e tanishme, e ardhshme, aktuale ose e mundshme;

f) një "**person**" përfshin çdo person, shoqëri, korporatë, partneritet, trust, qeveri, shtet apo agjenci shtetërore ose ndonjë shoqatë, ose grup prej dy ose më shumë nga sa më sipër (pavarësisht nëse ka ose jo personalitet të veçantë juridik);

g) një "**rregullore"** përfshin çdo legjislacion, rregullore, rregull, dekret, direktivë zyrtare, udhëzim, kërkesë, këshilla, rekomandim, vendim ose udhëzim (pavarësisht nëse ka ose jo forcën e ligjit) të ndonjë organi qeveritar, ndërqeveritar ose mbikombëtar, autoriteti mbikëqyrës, autoriteti rregullator, autoriteti të pavarur administrativ, agjencie, departamenti ose ndonjë ndarje të ndonjë autoriteti ose organizate tjetër (duke përfshirë çdo rregullore të lëshuar nga një ent publik industrial ose tregtar) që ka efekt në këtë Marrëveshje ose mbi të drejtat dhe detyrimet e një Pale;

h) një dispozitë e ligjit është një referencë për atë dispozitë, të ndryshuar;

i) përveç nëse parashikohet ndryshe, një kohë e ditës është një referencë për orën lokale të Parisit;

j) titujt e seksionit, klauzolës dhe skedulit janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

k) përveç nëse parashikohet ndryshe, fjalët dhe shprehjet e përdorura në çdo dokument tjetër që lidhen me këtë Marrëveshje ose në ndonjë njoftim të dhënë në lidhje me këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim në atë dokument ose njoftim si në këtë Marrëveshje;

l) një rast i mospërmbushjes së detyrimit "vazhdon" nëse nuk është korrigjuar ose nëse Huadhënësi nuk ka hequr dorë nga asnjë prej të drejtave të tij që lidhen me të;

m) një referencë për një klauzolë ose skedul do të jetë një referencë për një klauzolë ose skedul të kësaj Marrëveshje; dhe

n) fjalët që nënkuptojnë shumësin përfshijnë njëjësin dhe anasjelltas.

SKEDULI 2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e Projektit

Projekti synon të sigurojë banorët e Durrësit me shërbim me cilësi dhe të qëndrueshëm të furnizimit me ujë. Investimi do të mundësojë rinovimin e infrastrukturave për të mbështetur shërbimin e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Durrësit (SHUKD) në përmirësimin e performancës së saj operacionale, sipas strategjisë së saj 5-vjeçare, për periudhën 2018-2023. Objektivat e Projektit mbulojnë tri akset e zhvillimit të qëndrueshëm të shërbimit të ujit:

- Boshti social: përballja me kërkesën në rritje të vazhdueshme për ujë në zonën e shërbimit të SHUKD-së, duke përparuar drejt ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve, duke nxitur në këtë mënyrë zhvillimin e aktivitetit social ekonomik të rajonit.
- Boshti mjedisor: mbrojtja e burimeve ujore në sasi dhe cilësi, në një kontekst të rritjes së cënueshmërisë, e përforcuar nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.
- Boshti ekonomik: rritja e performancës operative dhe financiare të SHUKD-së dhe potenciali i rajonit të Durrësit për zhvillimin ekonomik.

Përmbajtja e Projektit

Projekti ndahet në 4 komponentë, 3 komponentë për punimet (1, 2 dhe 3) të cilët do të ekzekutohen sipas 2 ose më shumë kontratave; dhe 1 komponent të ndihmës teknike (4), i cili do të ekzekutohet sipas 1 ose më shumë kontratave.

Komponenti 1: Rinovimi i rrjetit të shpërndarjes në qendrën e qytetit Durrës – shuma indikative e vlerësuar[2] - 37 milionë euro. Ky komponent do të zbatojë studimin e projektimit të detajuar, të përgatitur nga Invictus në vitin 2020, pas shqyrtimit nga Konsulenti i Zbatimit të modelimit të rrjetit, përzgjedhjes së tubacionit, natyrës së punës, zgjedhjes së materialeve, llogaritjes së kostove, vizatimeve, rilevimit topografik kur është e nevojshme. Konsulenti i zbatimit do ta pasurojë atë me një shënim vlerësimi mjedisor dhe social dhe do ta ndajë planin e punës në lote dhe faza. Objektivi i këtij komponenti është sigurimi i vazhdueshëm i furnizimit me ujë në zonat e qendrës së qytetit të Durrësit dhe Kenata, si dhe reduktimi i humbjeve të ujit (NRW) (i cili do të ndahet me dy pas përfundimit të projektit).

Komponenti 2: rehabilitimi i sistemit të Fushë-Kuqe - 15.7 milionë euro. Ky komponent do të bëjë një pasqyrë të studimit të eficiencës së energjisë të realizuar nga Projekti Huk (financuar nga GIZ) në vitin 2014, i cili vlerësoi përfitimet e mundshme në 10 GWh/vit. Konsulenti i zbatimit do të përgatisë studime të fizibilitetit dhe projektimit përpara prokurimit të punimeve.

Komponenti 3: masterplani i kanalizimeve – shuma indikative e vlerësuar 1.3 milionë euro. Asistenti teknik do të përgatisë një masterplan, bazuar në ofrimin e parashikuar të shërbimit sanitar në vitin 2040.

Komponenti 4: ndihmë teknike për AKUM dhe menaxhimi i ndryshimit brenda SHUKD-së.

Konsulenti institucional do të vendosë në dispozicion një ekip prej dy personash në Tiranë dhe Durrës dhe do t'i ofrojë NJKP-së mbështetje për menaxhimin kontraktual, administrativ dhe financiar të projektit. Ata do të mbështesin NJKP-në në përgatitjen e dokumenteve përkatëse për vendimmarrje, si kërkesat për propozime dhe prova që nxisin pagesat e AFD-së për ndërmarrjet. Do të ofrojë mbështetje për AKUM-in në veprimtaritë dhe logjistikat ditore (automjet, zyrë dhe pajisje).

---

[2] E gjithë shuma e vlerësuar për komponentët e projektit ka një shkallë fleksibiliteti 10%. Duke pasur parasysh këtë shtrirje, buxheti i mbetur nga një komponent mund të rialokohet për një komponent tjetër.

Ndihma teknike/konsulenca institucionale do të kundërshtojë organizimin në të ardhmen të SHUKD-së për kornizën për planet në vazhdim për racionalizimin dhe mbledhjen e shërbimit të ujit të Shqipërisë, organizimin dhe procedurat për të gjitha shërbimet, si: burimet njerëzore, funksionimin dhe mirëmbajtjen, menaxhimin e klientit, faturimin dhe rikuperimin etj. Ai do të ndihmojë SHUKD-në të marrë dhe përditësojë mjetet e menaxhimit, të tilla si bazën e të dhënave të klientit, sistemin e informacionit gjeografik, sistemin e menaxhimit të operacioneve (SCADA), sistemet e zbulimit të rrjedhjeve etj. Një fond pajisjesh prej rreth 150 mijë euro do të vihet në dispozicion sipas këtij komponenti, për të blerë dhe instaluar instrumente për zbulimin e rrjedhjeve.

Zbatimi i Programit do të fillojë me zgjedhjen e konsulentëve me paketa kontratash siç përshkruhet më poshtë:

Konsulencë e zbatimit

Kontrata 1. projektim i detajuar, ndihmë në tenderim dhe mbikëqyrje të punimeve, për:

Komponenti 1. Rinovim i rrjetit të distribucionit në qytetin e Durrësit.

Komponenti 2. Rehabilitim i sistemit të Fushë-Kuqes.

Kontrata 2

Komponenti 3. Përgatitje e masterplanit të konceptit të kanalizimit të bazuar në periudhën e projektuar deri në vitin 2040.

Konsulencë institucionale/ ndihmë teknike

Kontratë 3

Komponenti 4. Masat shoqëruese për ndërtimin e kapacitetit dhe forcimin institucional të SHUKD-së dhe mbështetje për AKUM-in në zbatimin e programit.

- Shuma treguese e vlerësuar për shërbimet e konsulencës (komponenti 1, 2 dhe 4) është 7 milionë euro.

Organizimi institucional

AFD-ja do të financojë të gjithë projektin përmes një kredie prej 60 milionë euro dhe një granti prej 1 milion euro. Të dyja marrëveshjet e financimit do të nënshkruhen ndërmjet AFD-së dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë (MFE) do të jetë Huamarrësi dhe Përfituesi i Huas.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUM) do të jetë përgjegjëse për zbatimin e të gjithë koordinimit të zbatimit të programit. AKUM do të veprojë si Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP), përgjegjës për prokurimin dhe kontraktimin e punimeve dhe shërbimeve të konsulencës, si dhe monitorimin e përgjithshëm dhe raportimin e programit. Në kuadër të organizimit institucional të AKUM-it një staf i kualifikuar i dedikuar që formon NJKP-në do të trajtojë zbatimin e përditshëm të programit.

E gjithë infrastruktura dhe pajisjet e financuara nga projekti do të bëhen asete të SHUKD-së në fund të projektit.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe SHUKD-ja do të nënshkruajnë një Marrëveshje për Zbatimin e Projektit dhe asistenti teknik do të përgatisë një Manual të Aktiviteteve të Projektit, në fillim të projektit. Të dyja palët do të japin detaje mbi përgjegjësitë e palëve të interesuara dhe procedurat e zbatueshme për projektin.

Skeduli i zbatimit

Skeduli i zbatimit shtrihet në katër vite:

	Përshkrimi	**S1**	**S2**	**S3**	**S4**	**S5**	**S6**	**S7**	**S8**
1	Konsulencë institucionale/ndihmë teknike për komponentin 4	x	x	x	x	x	x	x	x
2	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 1								
	Projektimi i detajuar – rinovim i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Durrësit	x	x						
	Prokurimi i punimeve		x						
	Zbatimi i punimeve për rinovimin e rrjetit të Durrësit			x	x	x	x	x	x
3	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 2								

	Studimi i fizibilitetit/projektimi paraprak dhe projektimi i detajuar	x	x	x					
	Prokurimi i punimeve				x				
	Implementimi i punimeve për rehabilitimin e zonës së Fushë-Krujës					x	x	x	x
3	Shërbimet e konsulencës për zbatimin për komponentin 3								
	Përgatitje e masterplanit të higjienës publike		x	x	x				

Rezultatet e pritshme të projektit

Nëpërmjet këtij projekti, SHUKD-ja synon të përgjysmojë ujin pa të ardhura (NRW), aktualisht mbi 70%, që do të konsistojë në një reduktim të konsumit të ujit të papërpunuar prej 6 milionë m^3/vit (reduktim të humbjeve teknike) dhe rritje e ujit të faturuar me 6 milionë m^3 /vit (reduktim të humbjeve komerciale). Gjithashtu, rinovimi i pajisjeve të pompimit dhe zëvendësimi i tubacioneve të transmetimit pritet të gjenerojë një reduktim të konsumit të energjisë të SHUKD-së me 10 GWh/vit ose 16%.

Bazuar në këto hipoteza, norma e brendshme e kthimit të Projektit, gjatë një periudhë 20-vjeçare, arrin 8.02%. SHUKD-ja do të rrisë marzhin e saj bruto me 6.7 milionë euro, për t'u krahasuar me shpenzimet mesatare operative prej 8.5 milionë euro në vitin 2017 dhe 2018.

Arritja e këtij objektivi ambicioz do të kërkojë, përveç projektit, përpjekje të vazhdueshme të SHUKD-së në menaxhimin komercial të shërbimit, veçanërisht në zbatimin e matësve individualë dhe faturimin për të gjithë klientët. Do të kërkojë gjithashtu përpjekje në zbulimin dhe riparimin e rrjedhjeve, dhe në përgjithësi në mirëmbajtjen parandaluese të infrastrukturës dhe pajisjeve të SHUKD-së.

Projekti do të përmirësojë cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimit të furnizimit me ujë për popullsinë e rajonit të Durrësit, me një kosto më të ulët mjedisore. Do të ketë ndikime pozitive në uljen e pabarazive dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore nëntokësore. Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve do të rrisë pritshmëritë operacionale ndaj SHUKD-së dhe do të sjellë ndikime strukturore në qeverisjen e shërbimit të ujësjellësit në të gjithë vendin.

SKEDULI 3. PLANI I FINANCIMIT

Në EURO	**Totali**	**Huaja**	**Granti**
Punimet dhe furnizimet	52.700.00	52.700.00	0
Shërbimet e konsulencës	8.300.000	7.300.000	1.000.000
Total	**61.000.000**	61.000.000	1.000.000

SKEDULI 4. KUSHTET PARARENDËSE

Sa më poshtë zbatohet për të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Huamarrësi, si një kusht pararendës:

- nëse dokumenti i dorëzuar nuk është origjinal, por fotokopje, fotokopja origjinale e vërtetuar i dorëzohet Huadhënësit;

- versioni përfundimtar i një dokumenti, drafti i të cilit është dërguar më parë, dhe për të cilin është rënë dakord nga Huadhënësi, nuk do të ndryshojë materialisht nga drafti i rënë dakord;

- dokumentet që nuk janë dërguar më parë dhe mbi të cilat është rënë dakord, do të jenë të pranueshme për Huadhënësin.

PJESA I. KUSHTET PARARENDËSE QË DUHET TË PËRMBUSHEN NË DATËN E NËNSHKRIMIT

Dorëzimi nga Huamarrësi te Huadhënësi i dokumenteve të mëposhtme:

i) dëshmi se Këshilli i Ministrave ka miratuar "në parim" këtë Marrëveshje dhe detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

ii) kopjen origjinale të dokumentit përkatës të lëshuar nga autoriteti/et kompetent në Republikën e Shqipërisë që autorizon një ose më shumë persona të specifikuar për të ekzekutuar Marrëveshjen në emër të Huamarrësit.

PJESA II. KUSHTET PARARENDËSE PËR TËRHEQJEN E PARË TË FONDIT

a) Dorëzimi nga Huamarrësi te Huadhënësi i dokumenteve të mëposhtme:

i) dëshmi që, në mënyrë të pranueshme për Huadhënësin, legjislacioni i posaçëm i kërkuar nga Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë për ratifikimin e kësaj Marrëveshjeje është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi.

ii) një mendim ligjor i ekzekutuar sipas rregullave të ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë për Huadhënësin duke theksuar se Marrëveshja është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave nga dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe është ligjërisht i detyrueshëm për Huamarrësin në përputhje me termat e tij, në formë dhe përmbajtje e pranueshme për Huadhënësin.

iii) një letër të nënshkrimit model të personave të autorizuar për të nënshkruar, në emër të Huamarrësit, kërkesat e tërheqjes së fondit dhe çdo certifikatë në lidhje me këtë Marrëveshje dhe të marrë të gjitha masat e tjera dhe/ose të nënshkruajë të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme në emër të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

iv) dëshmi të pagesës nga Huamarrësi për Huadhënësin të tarifës së vlerësimit të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje;

v) marrëveshjen për zbatimin e Projektit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe SHUKD-së, e nënshkruar nga të dyja palët, duke përfshirë përgjegjësinë për SHUKD-në për: i) zbatimin e projektit të tij për dërgimin e matësve individual tek të gjithë klientët; ii) përcaktimin e një strategjie dhe zbatimin e një plani veprimi për të përmirësuar faturimin e ujit duke ulur në këtë mënyrë humbjet komerciale të ujit; iii) përcaktimin e një strategjie dhe zbatimin e një plani veprimi për të propozuar tarifa sociale për klientët e tij vulnerabël; iv) përcaktimin e një strategjie dhe zbatimin e një plani veprimi gjinor në përputhje me planin e veprimit kombëtar gjinor për ujësjellësin për të propozuar tarifa sociale për klientët e tij vulnerabël; iv) përcaktimin e një strategjie dhe zbatimin e një plani veprimi gjinor në përputhje me planin e veprimit kombëtar gjinor të ujësjellësit të zhvilluar sipas strategjisë kombëtare të ujësjellësit 2019-2030.

b) dhe për secilin nga dokumentet e Projektit të sipërpërmendura

- një kopje të vërtetuar të çdo dokumenti të Projektit, të nënshkruar rregullisht nga secila palë e saj;
- dëshmi se të gjitha formalitetet e kërkuara sipas dokumenteve të Projektit për lidhjen, përmbushjen dhe zbatueshmërinë ndaj palëve të treta të dokumenteve të tilla të projektit janë përmbushur; dhe
- dëshmi se çdo autorizim që Huadhënësi konsideron të nevojshëm ose të dëshirueshëm për lidhjen dhe përmbushjen, dhe transaksionet e përfshira nga, të çdo dokumentit të Projektit, është marrë sipas rregullave dhe dorëzimi i një kopje të vërtetuar të një autorizimi të tillë.

PJESA III. KUSHTET PARARENDËSE PËR TËRHEQJEN E DYTË TË FONDIT

Nga AFD nuk ka asnjë kundërshtim për Manualin e Veprimtarive të Projektit.

PJESA IV. KUSHTET PARARENDËSE PËR TË GJITHA TËRHEQJET E FONDEVE, PËRFSHIRË TËRHEQJEN E PARË TË FONDIT

a) Dorëzimi nga Huamarrësi nëpërmjet MIE/AKUM te Huadhënësi i udhëzimeve (në veçanti të informacionit të llogarisë së Kontraktuesit përkatës) të kërkuara për transferimin e tërheqjeve të fondeve direkt te Kontraktuesi, sipas kërkesës, dhe:

i.) të gjitha kontratat dhe formularët e porosive së bashku me çdo plan dhe kuotë (nëse është e zbatueshme) që i janë dhënë më parë Huadhënësit në përputhje me dhe siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimit, në lidhje me tërheqjen e fondit që kërkohet të paguhet drejtpërdrejt; dhe

ii. çdo raport, faturë ose kërkesë pagese të ndërmjetme, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin, të cilat mund të dorëzohen në formën e fotokopjeve ose dublikatave të certifikatave.

Sa më poshtë zbatohet për të gjitha dokumentet e dorëzuar nga Huamarrësi si një kusht pararendës:

- nëse dokumenti që është dorëzuar nuk është origjinale, por fotokopje, Huadhënësit i jepet fotokopje e vërtetuar e origjinalit;
- versioni përfundimtar i dokumentit drafti i të cilit është dërguar më parë dhe është rënë dakord nga Huadhënësi, nuk do të ndryshojë nga ana materiale nga drafti i rënë dakord;
- dokumente që nuk janë rënë dakord dhe është rënë dakord, do të jenë të pranueshme për Huadhënësin.

SKEDULI 5/A. FORMA E KËRKESËS PËR TËRHEQJEN E FONDIT

[në kokën e letrës së Huamarrësit]

Drejtuar: AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT
Mbi: [*datë*]
Emri i Huamarrësit – Marrëveshje e Shumës së Kredisë n° [•] datë [•]
Kërkesë për tërheqje fondi n°[•]
Të nderuar zotërinj,

1. Ne i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Kredisë n ° [•] të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit në datën [•] ("**Marrëveshja**"). Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura, por që nuk janë përcaktuar këtu kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në Marrëveshje.

2. Kjo letër është një kërkesë për tërheqje fondi.

3. Ne kërkojmë në mënyrë të parevokueshme që Huadhënësi të vendosë në dispozicion një tërheqje fondi, në kushtet e mëposhtme:

Shuma: EURO [•] ose, nëse është më pak, kredia në dispozicion.
Norma e interesit: [*fikse / e ndryshueshme*]

4. Norma e interesit do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e klauzolës 4 (*Interesi*) dhe klauzolës 5 (*Ndryshimi në llogaritjen e interesit*) të Marrëveshjes. Norma e interesit e aplikueshme për tërheqjen e kërkuar të fondit do të na jepet me shkrim dhe ne e pranojmë këtë normë interesi [(sipas paragrafit më poshtë, nëse është e zbatueshme)], duke përfshirë kur norma e interesit përcaktohet duke iu referuar një standardi të zëvendësimit plus ndonjë marzhi rregullimi, siç njoftohet nga Huadhënësi pas ndodhisë së një rasti zëvendësimi të normës së përqindjes vjetore.

[**Vetëm për normën fikse të interesit**:] Nëse norma e interesit e aplikueshme për tërheqjen e kërkuar të fondit është më e madhe se [•] ([•]%), ne kërkojmë që të anuloni këtë kërkesë për tërheqje fondi.

5. Ne konfirmojmë që secili kusht i specifikuar në klauzolën 2.4 (*Kushtet pararendëse*) të përmbushet në datën e kësaj kërkese për tërheqje fondi dhe asnjë ngjarje e mospërmbushjes së detyrimeve nuk po vazhdon ose nuk ka të ngjarë të ndodhë. Ne jemi dakord të njoftojmë Huadhënësin menjëherë nëse ndonjë prej kushteve të përmendura më lart nuk është përmbushur në ose para datës së tërheqjes së fondit.

6. Të ardhurat e kësaj tërheqje fondi duhet të kreditohen në llogarinë e mëposhtme bankare:
a) emri [i Huamarrësit]: [•]
b) adresa [e Huamarrësit]: [•]
c) IBAN numri i llogarisë: [•]
d) numri SWIFT: [•]
e) Banka dhe adresa e bankås [e Huamarrësit]:
f) [nëse është valutë tjetër përveç euros] banka dhe përkatëse dhe numri i llogarisë të bankës së Huamarrësit: [•]

7. Kjo kërkesë për tërheqje fondi është e parevokueshme.

8. Bashkëlidhur kësaj kërkese për tërheqje fondi gjeni të gjitha dokumentet përkatëse mbështetëse, të specifikuara në klauzolën 2.4 (*Kushti pararendës*) i Marrëveshjes:
[Lista e dokumenteve mbështetëse]

Me respekt,

_____
Nënshkruesi i autorizuar i Huamarrësit.

SKEDULI 5/B. FORMA E KONFIRMIMIT TË TËRHEQJES SË FONDIT DHE NORMA
[në letrën me kokë të Agence Française de Développement]

Drejtuar: [Huamarrësit]
Mbi: [•]
Lënda: Kërkesë për tërheqje fondi n°[•]datë [•]
Emri i huamarrësit – Marrëveshje e Shumës së Kredisë n° [•] datë [•]

Konfirmim për tërheqje fondi n°[•]

Të nderuar zotërinj,

1. Ne i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Kredisë n° [•] të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit në datën [•] ("**Marrëveshja**"). Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura, por që nuk janë përcaktuar këtu kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në Marrëveshje.

2. Me anë të një kërkese për tërheqje fondi, e datës [•], Huamarrësi ka kërkuar që Huadhënësi të vendosë në dispozicion një tërheqje fondi në shumën EURO [•], në zbatim të afateve dhe kushteve të Marrëveshjes.

3. Tërheqja e fondit që është vendosur në dispozicion sipas kërkesës suaj për tërheqje fondi është si vijon:

- Shuma: EUR [• *shuma me fjalë*] ([•])
- Norma e aplikueshme e interesit: [•*përqindja me fjalë*] për qind ([•]%) në vit [e barabartë me totalin e EURIBOR-it gjashtëmujor (e barabartë me [•]% në vit)[3] dhe marzhi][4]
- Data e tërheqjes së fondit: [•]

Vetëm për huat me normë fikse interesi

Vetëm për qëllime informacioni

- Data e vendosjes së normës: [•]
- Norma fikse e referencës: [• *përqindja me fjalë*] ([•]%) në vit

· Norma efektive globale (në vit): [• *përqindja me fjalë*] ([•]%)

- Norma e indeksit: [• *përqindja me fjalë*] ([•]%) në vit

· Norma e indeksit në datën e vendosjes së normës së indeksit: [•]

[Duke specifikuar se norma e mësipërme e interesit mund të ndryshojë në përputhje me dispozitat e klauzolave 4.1.1 (i) (*Norma e ndryshueshme e interesit*) dhe 5.2 (*Zëvendësimi i normës së përqindjes vjetore)* të Marrëveshjes.] [5]

Me respekt,

.....

Nënshkruesi i autorizuar i *Agence Française de Développement*

SKEDULI 5C. FORMA E KËRKESËS PËR KONVERTIMIN E NORMËS

[në letrën me kokë të Huamarrësit]

Drejtuar: AGENCE FRANÇAISE DE DÉVELOPPEMENT

Mbi: [*datë*]

Emri i huamarrësit – Marrëveshje e Shumës së Kredisë n° [•] datë [•]

Kërkesë për konvertimin e normës n°[•]

Të nderuar zotërinj,

1. Ne i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Kredisë n° [•] e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit në datën [•] ("**Marrëveshja**"). Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura, por që nuk janë përcaktuar këtu kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në Marrëveshje.

2. Në bazë të klauzolës 4.1.3 (i) (*Konvertimi nga një normë e ndryshueshme interesi në një normë fikse interesi*) të Marrëveshjes, kërkojmë nga ana juaj të konvertoni normën e ndryshueshme të interesit të Tërheqjeve të mëposhtme të fondeve:

- [***listoni tërheqjet përkatëse të fondeve***],

---

[3] Nëse EURIBOR-i gjashtëmujor nuk është i disponueshëm në datën e konfirmimit të tërheqjes së fondit për shkak të ndodhisë së një rasti zëvendësimi të normës së përqindjes vjetore, standardi i zëvendësimit, termat dhe kushtet e sakta të zëvendësimit të një norme të tillë të përqindjes vjetore me një standard zëvendësimi dhe normat totale efektive përkatëse do t'i komunikohen Huamarrësit në një letër të veçantë.

[4] Duhet të fshihet në rastin e një norme interesi fikse

[5] Duhet të fshihet në rastin e një norme interesi fikse.

në një normë fikse interesi, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

3. Kjo kërkesë për konvertimin e normës do të konsiderohet e pavlefshme nëse norma fikse e interesit në fuqi tejkalon [•] [•%].

Me respekt,

_____

Nënshkruesi i autorizuar i Huamarrësit

SKEDULI 5/D. FORMA E KONFIRMIMIT TË KONVERTIMIT TË NORMËS

[në letrën me kokë të Agence Française de Développement]

Drejtuar: [Huamarrësit]
Mbi: [•]
Lënda: Kërkesë për konvertimin e normës n°[•] datë [•]
Emri i Huamarrësit – Marrëveshje e Shumës së Kredisë n° [•] datë [•]
Konfirmim i Konvertimit të Normës n°[•]

Të nderuar zotërinj,

LËNDA: Konvertimi nga një normë e ndryshueshme interesi në një normë fikse interesi

1. Ne i referohemi Marrëveshjes së Shumës së Kredisë n° [•] e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit në datën [•] ("**Marrëveshja**"). Fjalët dhe shprehjet me germa kapitale të përdorura, por që nuk janë përcaktuar këtu kanë kuptimet që u janë dhënë atyre në Marrëveshje.

2. Ne i referohemi gjithashtu kërkesës suaj për konvertimin e normës e datës [•]. Ne konfirmojmë që norma fikse e interesit e zbatueshme për tërheqjen/et e fondit të përmendur në kërkesën tuaj të konvertimit të normës, e dorëzuar në përputhje me klauzolën 4.1.3 (i) (*Konvertimi nga një normë e ndryshueshme interesi në një normë fikse interesi*) të Marrëveshjes është:

- [•]% në vit.

3. Kjo normë fikse e interesit, e llogaritur në përputhje me klauzolën 4.1.1 (*Përzgjedhja e normës së interesit*) do të zbatohet për tërheqjen/et e fondit të referuar në kërkesën tuaj të konvertimit të normës nga [•] (data e hyrjes në fuqi).

4. Gjithashtu, ju njoftojmë se norma efektive globale në vit e shumës është [•] %.

Me respekt,

_____

Përfaqësues i autorizuar i *Agence Française de Développement*

SKEDULI 6. PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

1. Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (ESCP) synon të konsolidojë në një dokument të vetëm masat dhe veprimet materiale që Projekti të zbatohet në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të AFD-së dhe për pranueshmërinë e AFD-së.

2. ESCP-ja paraqet në një mënyrë të saktë angazhimet e bëra nga Huamarrësi për të shmangur, minimizuar, reduktuar ose kompensuar ndikimet e mundshme të Projektit për mjedisin njerëzor dhe natyror, duke përfshirë të gjitha fazat e projektit: projektimi, ndërtimi dhe funksionimi.

3. Standardet mjedisore dhe sociale të zbatuara nga AFD-ja bazohen në:

- Politikën e Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Riskut për Funksionimin e financuar nga AFD-ja. https:www.afd.fr/en/resources/environmental-and-social-risk-management-policy-afd-funded-operations.
- Kuadri Mjedisor dhe Social (ESF)- Grupi i Bankës Botërore: http://documents.ëorldbank.org/curated/en/383011492423734099/pdf/114278-ËP-REVISED-PUBLIC-Environmental-and-Social-Frameëork.pdf.

- Udhëzimet mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë- Grupi i Bankës Botërore: https:www.ifc.org/wps/wcn/connect/Topics_Ext_Content/IFC_External_Corporate_Site./Sustainability-Ay-IFC/Policies-Standards/EHS-Guidelines/

- Konventat kryesore/themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) të ratifikuara nga Shqipëria.

4. AKUM/NJKP është përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e angazhimeve të listuar më sipër.

ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
1.	**Monitorimi dhe raportimi**			
1.1 Raportimi i rregullt	1.1.1.Të përgatitet dhe dorëzohet AFD-së në bazë të rregullt, raportet e monitorimit mbi performancën Mjedisore, Sociale, të Shëndetit dhe Sigurisë (ESHS) të Projektit, duke përfshirë, por pa kufizuar zbatimin e ESCP-së, statusin e përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve të E&S të kërkuara sipas ESCP-së, aktivitetet e angazhimit të aktorëve, funksionimin e mekanizmit/ve të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.	AKUM/NJKP	Duke filluar nga data efektive e Marrëveshjes së Shumës së Kredisë. Çdo vit gjatë zbatimit të Projektit.	Raporte vjetore të pavarura ESHS ose seksioni i pavarur ESHS në raportet e progresit të Projektit që duhet të jenë të pranueshme për AFD-në.
1.2 Incidentet dhe aksidentet	1.1.2.Të njoftohet menjëherë AFD-ja për ndonjë incident ose aksident lidhur me Projektin që ka ose mund të ketë një ndikim negativ të konsiderueshëm për mjedisin, trashëgiminë kulturore, komunitetet e prekura, publikun ose punonjësit, duke përfshirë ndër të tjera, rastet e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit (SEA), ngacmimin seksual (SH); aksidentet që rezultojnë në vdekje, dëmtim i rëndë ose i shumëfishtë; dhe çdo përhapje e COVID-19 në zonën e Projektit	AKUM/NJKP	Çdo aksident apo incident do t'i njoftohet menjëherë drejtuesit të ekipit të detyrës të AFD-së, pas shënimit të incidentit apo aksidentit. Raporti i aksidentit apo incidentit do të dorëzohet tek AFD-ja brenda 48 orësh pas informimit për incidentin apo aksidentin. Një raport i detajuar do të dorëzohet pranë AFD-së jo më vonë se 7 ditë pune pasi SHUKD-ja mëson për incidentin ose aksidentin, përveç në rast se bihet dakord për një afat kohor të ndryshëm në një mënyrë të pranueshme për AFD-në. Ky sistem i njoftimit/raportimit do të vendoset në funksion përgjatë zbatimit të Projektit.	Të gjitha aksidentet dhe incidentet do t'i raportohen menjëherë AFD-së. Të gjitha incidentet dhe aksidentet do t'i raportohen AFD-së ose në raportet vjetore të pavarura të ESHS-së ose në seksionin e dedikuar të ESHS-së në raportet e progresit të Projektit për pranueshmëri nga ana e AFD-së.
1.3 Raportet e rregullta të Kontraktuesve	1.3.1 AKUM/NJKP duhet t'u kërkojnë Kontraktuesve të sigurojnë raporte monitorimi tremujore për AKUM/ NJKP për performancën mjedisore, sociale, të shëndetit dhe sigurisë (ESHS) në përputhje me sistemet matëse mjedisore dhe sociale në dokumentet dhe kontrata përkatëse të detyrueshme. AKUM/NJKP do t'i dorëzojë këto raporte AFD-së me kërkesë të AFD-së.	AKUM/NJKP/ Konsulenti/Kontraktuesi	Kontraktuesit duhet të dorëzojnë raportet e rregullta çdo tre muaj me kërkesë të AKUM/NJKP (në rastin e situatave me incident apo të paparashikuar). NJZP-ja do t'i dorëzojë raporte tremujore AFD-së, kur kërkohet. Sistemi i raportimit do të jetë në funksion përgjatë zbatimit të Projektit.	Raportet e monitorimit të ESHS-së të Kontraktuesit mund të kërkohen nga AFD-ja.

ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
2.	**Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale të rreziqeve**			
2.1 Struktura organizative	2.1.1 AKUM/NJKP me mbështetjen e Konsulentit Institucional me stafin e kualifikuar dhe burimet e duhura për të mbështetur menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimeve të ESHS-së të Projektit, duke përfshirë 1 specialist të mjedisit dhe social me kohë të plotë dhe 1 specialist të shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS) me kohë të plotë, përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë e plotë me rregulloren e mjedisit dhe të punës të Shqipërisë, të gjithë me eksperiencën dhe kualifikimet e pranueshme për AFD-në.	AKUM/NJKP-Konsulenti Institucional	Konsulenti institucional do të mbështesë AKUM/NJKP lidhur me çështjet e ESHS-së, duke përfshirë specialistët që do të mbahen përgjatë zbatimit të Projektit.	Përbërja organizative e stafit të komponentëve institucionalë të dedikuar për të mbështetur AKUM/NJKP me CV-të e specialistëve të ESHC-së do të marrin NOC të AFD-së. Ndryshimet e stafit mbështetës dhe zëvendësimi i ndonjë specialisti të ESHC-së do të marrë NOC të AFD-së.
2.2 Vlerësimet mjedisore dhe sociale/planet e menaxhimit/specifikimet e punimeve	2.2.1 Një konsulent i mjedisit dhe social që do të punësohet nga AKUM/NJKP dhe monitorohet nga NJZP-ja, do të jetë përgjegjës për të përgatitur një VNMS që do të përfshijë një PMMS, për çdo nën-projekt.	AKUM/NJKP	VNMS/PMMS do të përgatitet në lidhje me projektimin konceptual të projektit.	VNMS/PMMS do të marrë një NOC nga AFD-ja.
	2.2.2 AKUM/NJKP do të jetë përgjegjës për të përfshirë aspektet përkatëse të kësaj ESCP, VNMS, PMMS dhe çdo masë tjetër	AKUM/NJKP	Masat përkatëse të ESHS-së do të përfshihen në dokumentet e prokurimit	Dokumentacioni i prokurimit dhe kontrata e kontraktuesve do të marrë një NOC nga AFD-ja.

	përkatëse të ESHS-së, në specifikimet e ESHS-së të dokumentacionit të prokurimit të Kontraktuesit. Pas kësaj, AKUM/NJKP do të sigurojë që Kontraktuesit zbatojnë kërkesat e ESHS-së të kontratave të tyre.		përpara lançimit të procesit të prokurimit për aktivitetet përkatëse të Projektit dhe më pas në pajtueshmëri gjatë kryerjes së këtyre aktiviteteve.	
3. **Puna dhe kushtet e punës**				
3.1 Masat e shëndetit dhe sigurisë në punë	3.1.1 Kontraktuesit do të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë planet dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë (OHS), që mbulojnë përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave, trajnimet e punëtorëve të projektit për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme (pajisjet e mbrojtjes personale, ndihma e parë, pajisjet zjarrfikëse, tensioni i lartë etj.), dëmtimet dhe për të zbutur ndikimet në komunitetet lokale, siç përshkruhen në PMMS. Planet dhe masat e OHS-së do të bazohen në VNMS-në dhe PMMS-në dhe në legjislacionin dhe rregulloret e Shqipërisë për punën.	AKUM/NJKP-Konsulenti Institucional	Masat e OHS-së duhet të zbatohen përgjatë zbatimit të Projektit dhe monitorimi të raportohet në raportin gjysmë vjetor të ESHS-së të AKUM/NJKP/Konsulentit.	Planet dhe masat e sigurisë dhe shëndetit në punë të Projektit të përgatitura nga Kontraktuesit do të marrin NOC të AFD-së.

ASPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
4. Efektshmëria e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes				
4.1 Efektshmëria e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes	4.1.1 Si pjesë e përgatitjes së VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të konsiderojë sipas nevojës, se çfarë është përkatëse në lidhje me këtë aspekt, përfshirë ndër të tjera, menaxhimin e mbetjeje, menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, efektshmërinë e burimeve, furnizimin me ujë dhe mbrojtjen e dheut etj. AKUM/NJKP do të përfshijë ato aspekte përkatëse në specifikimet e ESHS-së të dokumenteve të prokurimit dhe në kontratën me Kontraktuesin e cila nga ana e tij do të përgatisë, zbatojë dhe ruajë plane të ndryshme lidhur me mjedisin, si pjesë e ndërtimit të PMMS-së, përfshirë Planin e Menaxhimit të Mbetjeve që do të përcaktojë sasitë e mbetjeve, kategorizimin e tyre dhe trajtimin, ruajtjen, transportin e propozuar dhe masat në dispozicion.	AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së	I njëjti afat kohor për zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe entet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së. Një objekt i licencuar për shkatërrimin/përpunimin e niveleve të konsiderueshme të mbetjeve të rrezikshme do të identifikohet dhe kontraktohet përpara fillimit të punimeve.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin. Licenca e objektit për shkatërrimin/përpunimin e niveleve të konsiderueshme të mbetjeve të rrezikshme do të pajisen me NOC të AFD-së.
5. Shëndeti dhe siguria në komunitet				
5.1 Shëndeti dhe siguria në komunitet	5.1.1 Si pjesë e përgatitjes së VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të konsiderojë sipas nevojës se çfarë është përkatëse në lidhje me këtë aspekt, përfshirë ndër të tjera: minimizimin e mundësisë për ekspozimin e komunitetit ndaj sëmundjeve të transmetueshme; krijimin dhe zbatimin e sistemeve të duhura të menaxhimit të cilësisë për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet që shërbimet e ofruara dhe aktivitetet e kryera sipas Projektit mund të kenë në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit; përfshirë ndër të tjera parandalimin dhe reagimin ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit seksual, si dhe ngacmimit seksual. AKUM/NJKP do të përfshijë gjithashtu aspektet përkatëse në specifikimet e ESHS-së të dokumenteve të prokurimit dhe në kontratën me Kontraktuesin që nga ana tjetër do të përgatisë, zbatojë dhe ruajë plane të ndryshme lidhur me menaxhimin si pjesë e ndërtimit të PMMS-së, duke përfshirë Planin e Menaxhimit të Trafikut (PMT) për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese dhe punimeve të tjera që mund të çmohen të arsyeshme.	AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së	I njëjti afat kohor për zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe entet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1. më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin.

SPEKTI	VEPRIMI	SUBJEKTI PËRGJEGJËS	PLANI KOHOR DHE AFATET	INDIKATORI I ARRITJEVE
6. Trashëgimia kulturore				
6.1 Menaxhimi i	6.1.1 Duke pasur parasysh trashëgiminë kulturore dhe		I njëjti plan kohor për	Shikoni pikën 2.2.1 më lart

trashëgimisë kulturore	tiparet arkeologjike të Durrësit, konsulenti i E&S-së do të vlerësojë me kujdes, si pjesë e zhvillimit të VNMS-së dhe PMMS-së, ndikimin e Projektit në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë. AKUM/NJKP do të përfshijë në specifikimet e Punës të dokumentacionit të prokurimeve dhe në kontratën me Kontraktuesin, të gjitha masat e lehtësimit nga VNMS-ja dhe PMMS-ja lidhur me trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë. Nga ana tjetër, Kontraktuesi do të përgatisë, zbatojë dhe ruajë një Plan Menaxhimi për Trashëgiminë Kulturore (PMTK) që do të përfshijë gjithashtu një procedurë për gjetjen e mundësisë për çdo punim, duke përfshirë gërmimet në rrugën e qytetit të vjetër të Durrësit. AKUM/NJKP do të përfshijë autoritetet kombëtare dhe/ose lokale të përfshira në trashëgiminë Kulturore dhe arkeologjinë, në çdo hap të projektimit dhe zbatimit të Projektit.	SHUKD AKUM/NJKP Konsulenti i E&S-së Kontraktuesi	zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Detyrimi kontraktual do të përfshihet në kontratat përkatëse me kontraktuesit dhe subjektet mbikëqyrëse me nënshkrimin e këtyre kontratave. Menaxhimi i aspekteve përkatëse do të ruhet gjatë zbatimit të Projektit dhe do të raportohet në raportin e ESHS-së.	për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit. Shikoni pikën 1.1.1. më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me raportimin.
7. Angazhimi i aksionerëve dhe zbulimi i informacionit				
7.1 Plani i Angazhimit të Aktorëve	7.1 1.Si pjesë e VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të përgatisë Planin e Angazhimit të Aktorëve (SEP);	Konsulenti i E&S-së	Si pjesë e VNMS-së, SEP do të përgatitet në lidhje me projektimin konceptual të Projektit.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit.
7.2 Mekanizmi për zgjidhjen e ankesave	7.2.1. Si pjesë e VNMS-së, konsulenti i E&S-së do të përgatisë një Mekanizëm për Trajtimin e Ankesave (GRM). SHUKD-ja, me mbështetjen e AKUM/NJKP do të publikojë, ruajë dhe operojë për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave në lidhje me Projektin, shumë shpejt dhe në mënyrë të efektshme, në mënyrë transparente, që është e duhur nga ana kulturore dhe e aksesueshme për palët e prekura të Projektit, pa kosto dhe pa ndëshkim, duke përfshirë shqetësimet dhe ankesat e dorëzuara në mënyrë anonime.	SHUKD Konsulenti i E&S-së	Mekanizmi për zgjidhjen e ankesave do të ruhet dhe mbahet operacionale përgjatë zbatimit të projektit. Ankesat dhe zgjidhja e tyre do të raportohet në raportin vjetor të ESHS-së.	Shikoni pikën 2.2.1 më lart për indikatorin e arritjeve lidhur me zhvillimin e VNMS/PMMS të Projektit.

SKEDULI 7. FORMA E RAPORTIT TË NDJEKJES SË INDIKATORËVE TË PROJEKTIT

Indikatori	**Llogaritja dhe burimi**	**Vlerat që nga data e nënshkrimit**
Numri i personave të sapo lidhur me rrjetin e ujit të pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	20,000 persona
Numri i personave, sistemi i ujit të pijshëm të të cilëve është përmirësuar	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona
Ekonomitë në ujin e pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	6,000,000 m3/vit
Ekonomitë në konsumin e energjisë	Raportet vjetore të SHUKD-së	10 GWh/vit
Numri i personave të cilëve u është përmirësuar qëndrueshmëria klimatike	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona
% e konsumatorëve që përfitojnë nga shërbimi i vazhdueshëm i ujit	Raportet vjetore të SHUKD-së	0%
% e njerëzve të lidhur në zonën e shërbimit SHUKD	Raportet vjetore të SHUKD-së	94% urban 83% rural
Norma e ujit pa të ardhura	Raportet vjetore të SHUKD-së	74%
Energjia e konsumuar për m^3 ujë të pijshëm të prodhuar dhe të ujërave të zeza të trajtuara	Raportet vjetore të SHUKD-së	1.5 kWh ujë të pijshëm; 0.5 kWh ujërat e zeza

SKEDULI 8. INFORMACIONI QË HUADHËNËSI ËSHTË I AUTORIZUAR SHPREHIMISHT TË ZBULOJË NË FAQEN E INTERNETIT TË HUADHËNËSIT (NË VEÇANTI NË PLATFORMËN E TIJ TË HAPUR TË TË DHËNAVE)

1. Informacion lidhur me Projektin
- Numri dhe emri në librin e AFD-së;
- Përshkrimi;
- Sektori operues;
- Vendi i zbatimit;
- Data e pritshme e fillimit të projektit;
- Data e pritshme e përfundimit teknik;
- Statusi i implementimit i përditësuar në bazë gjysmë vjetore;

2. Informacion lidhur me financimin e Projektit
- Lloji i financimit (hua, grant, bashkëfinancim, fonde të deleguara);
- Masa e principalit të shumës;
- Masa totale e tërhequr në bazë vjetore;
- Planifikimi i shumave të tërheqjes së fondit në bazë trevjeçare; dhe

- Sasia e shumës që është tërhequr (e përditësuar sipas ecurisë së zbatimit të Projektit);

3. Informacion tjetër

- Njoftimi mbi informacionin e transaksionit, bashkangjitur këtij skeduli; dhe
- Përmbledhja e vlerësimit të projektit, përmbajtja e së cilës përcaktohet në nenin 11.12 "Vlerësimi i Projektit".

SHTOJCA 8-1. NJOFTIMI MBI INFORMACIONIN E TRANSAKSIONIT

SHQIPËRIA Rindërtimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të Durrësit	

Projekti synon të mbështesë Republikën e Shqipërisë dhe në mënyrë specifike autoritetet e Ujësjellësit të Durrësit për të përmirësuar performancën e tyre operacionale, duke u fokusuar në zhvillimin ekonomik, reduktimin e pabarazisë dhe qeverisjen e sektorit.

KONTEKSTI

Burimet ujore të Shqipërisë janë ndër më të bollshmet në Evropë, por me një shpërndarje të pabarabartë gjeografike dhe temporale. Uji i pijshëm prodhohet dhe shpërndahet nga 58 operatorë bashkiakë, performanca operacionale dhe financiare e të cilëve është relativisht e ulët. Prandaj, Shteti Shqiptar ka vendosur të injektojë rreth 12 milionë euro në vit për të kompensuar deficitet operuese.

Për të përmirësuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit të furnizimit me ujë dhe për të qenë në përputhje me standardet Evropiane në funksion të aderimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka investuar masivisht në sektorin e ujësjellësit me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Gjithashtu, një reformë e madhe sektoriale është në proces.

Durrësi ka përjetuar dy tërmete në vitin 2019. Ky projekt është përfshirë në programin kombëtar të rindërtimit pas tërmetit, pasi përmirësimi i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve konsiderohet strategjike për zhvillimin e aktivitetit të turizmit dhe biznesit në Durrës, dhe ka një ndikim shumë të madh në të gjithë zhvillimin ekonomik të vendit.

PËRSHKRIMI

Projekti synon të mbështesë shërbimin e ujësjellësit të Durrësit (SHUKD) në përmirësimin e performancës së saj operacionale, në linjë me strategjinë pesëvjeçare që miratoi në vitin 2018, në mënyrë specifike, ky projekt, do të: i) përmbushë kërkesën për shërbimet e vazhdueshme dhe me cilësi për të mbështetur aktivitetet sociale-ekonomike; ii) kufizojë ndikimet mjedisore duke ruajtur sasinë dhe cilësinë e burimeve; dhe iii) përmirësojë performancën ekonomike, financiare dhe operacionale të SHUKD-së.

Vendi: Shqipëria
Data e nënshkrimit të marrëveshjes: 15.11.2022
Sektorët: Ujësjellësi dhe kanalizimet, qytetet e qëndrueshme
Lokalizimi: Durrës
Kohëzgjatja e financimit: 20 vjet
Instrumenti i financimit: Hua sovrane dhe granti i asistencës teknike
Shuma e financimit: 61 milionë euro
Përfitues: Republika e Shqipërisë
Menaxhimi i Projektit: AKUM
SDG-të kryesore:



Kodi i Projektit: CAL1012

Projekti ka katër komponentë:

1. Rinovimi i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Durrësit (37 milionë euro);
2. Rehabilitimi i stacionit të pompës Fushë-Kuqe dhe tubacionit të transferimit të ujit (15.7 milionë euro);
3. Realizimi i masterplanit të kanalizimit për rajonin e Durrësit (1.3 milionë euro);
4. Mbështetje për SHUKD-në dhe koordinimin e projektit.

Shuma indikative e vlerësuar e shërbimeve të konsulencës (komponentët 1, 2 dhe 4) është 7 milionë euro.

REZULTATET

Projekti do të ketë efekte përfituese të konsiderueshme, lidhur me:

- zhvillimin social-ekonomik të rajonit, nëpërmjet përmirësimit të performancës së operatorit dhe në këtë mënyrë duke sjellë përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujësjellësit;
- reduktimin e pabarazive, duke siguruar disponueshmërinë e shërbimit thelbësor të ujësjellësit, për të gjithë me një çmim të përballueshëm;
- qeverisje e sektorit, nëpërmjet mbështetjes së rëndësishme për ndërtimin e kapaciteteve të operatorit. Projekti do të ndihmojë në përgatitjen e strategjisë së SHUKD-së të vendosjes së çmimeve për popullsitë vulnerabël.

AKTORËT DHE MODUS OPERANDI

Huamarrësi do të jetë Republika e Shqipërisë

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), një agjenci e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) do të jetë pronari i projektit.

MIE/AKUM dhe SHUKD-ja kanë nënshkruar një marrëveshje për zbatimin e projektit, për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm. Asistenca e plotë teknike do të vendoset në funksion për të mbuluar komponentin 4 të projektit. AKUM-i do të jetë përgjegjës për të gjithë zbatimin dhe prokurimin e programit, me secilin hap sipas opinionit jokundërshtues të AFD-së që do të disbursojë fondet direkt për ofertuesit.

PLANI I FINANCIMIT

Kostoja e projektit kushton 61 milionë euro, duke përfshirë një hua sovrane 60 milionë euro dhe një grant 1 milion euro, të dhënë si pjesë e përpjekjeve të ndërtimit pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019.

Granti një milion euro do të financojë pjesërisht kontratën e asistencës teknike që plotëson huan.

SKEDULI 9. FORMULARI I RAPORTIT TË NDJEKJES SË INDIKATORËVE TË PROJEKTIT

Indikatori	**Llogaritja dhe burimi**	**Vlerat që nga data e nënshkrimit**
Numri i personave të sapo lidhur me rrjetin e ujit të pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	20,000 persona
Numri i personave, sistemi i ujit të pijshëm të të cilëve është përmirësuar	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona
Ekonomitë në ujin e pijshëm	Raportet vjetore të SHUKD-së	6,000,000 m^3/vit
Ekonomitë në konsumin e energjisë	Raportet vjetore të SHUKD-së	10 GWh/vit
Numri i personave të cilëve u është përmirësuar qëndrueshmëria klimatike	Raportet vjetore të SHUKD-së	350,000 persona
% e konsumatorëve që përfitojnë nga shërbimi i vazhdueshëm i ujit	Raportet vjetore të SHUKD-së	0%
% e njerëzve të lidhur në zonën e shërbimit SHUKD	Raportet vjetore të SHUKD-së	94% urban 83% rural
Norma e ujit pa të ardhura	Raportet vjetore të SHUKD-së	74%
Energjia e konsumuar për m^3 ujë të pijshëm të prodhuar dhe të ujërave të zeza të trajtuara	Raportet vjetore të SHUKD-së	1.5 kWh ujë të pijshëm; 0.5 kWh ujërat e zeza

SKEDULI 10. LISTË JOSHTERUESE E DOKUMENTEVE MJEDISORE DHE SOCIALE QË HUAMARRËSI LEJON TË ZBULOHEN NË LIDHJE ME PROCEDURËN E PUNËS TË MEKANIZMIT TË MENAXHIMIT TË ANKESAVE E&S

- Raporti i objektit E&S
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS)

- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS)
- Kuadri i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS)
- Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZH)
- Kuadri i Politikave për Zhvendosje (KPZH)
- Plani i Angazhimit Mjedisor dhe Social (PAMS)
- Vlerësimi i kufizuar mjedisor dhe social
- Plani i kufizuar i veprimit mjedisor dhe social
- Kapitulli nga studimi i fizibilitetit mjedisor dhe social
- Kapitujt nga raportet e monitorimit mjedisor dhe social
- Raportet e monitorimit të zbatimit të PAMS-it

SKEDULI 11. NDARJA E TË DHËNAVE TË BIODIVERSITETIT

Natyra e të dhënave

Të dhënat e biodiversitetit të mbuluar nga klauzola e Ndarjes së të Dhënave të Biodiversitetit të kësaj Marrëveshjeje janë të dhënat e vëzhgimit të florës dhe të faunës, të mbledhura si pjesë e inventarëve të fushës natyraliste të dedikuar për Projektin. Këto të dhëna mund të rezultojnë nga pamjet vizuale, vëzhgimet dëgjimore, regjistrimet ose mbledhjet e speci enëve.

Çdo pikë e publikuar e të dhënave, do të përfshijë të paktën informacionin lidhur me: llojin e vëzhgimit, emrin shkencor të taksonit, datën dhe vendndodhjen e vëzhgimit.

Përveç nëse të dhënat mund të çmohen sensitive, vëzhgimet mund të publikohen duke përdorur të njëjtën saktësi të vendndodhjes si ajo e mbledhur në terren.

Të dhënat që mund të çmohen sensitive janë, në veçanti, vëzhgimet e faunës dhe florës vendase, mbijetesa e të cilës brenda popullsisë lokale kanoset për shkak të heqjes me qëllim ose shkatërrimit të specimeneve. Siguruesi i të dhënave do të çrregullojë me qëllim saktësinë e detajeve të vendosjes për të ashtuquajturat specie sensitive. Masa e degradimit të detajeve të vendndodhjes do të përshtatet për sensitivitetin e specieve për të parandaluar çdo risk të presionit të mëtejshëm mbi popullsitë e atyre specieve në fjalë.

Procedurat për ndarjen e të dhënave

Të dhënat e biodiversitetit të Projektit do të publikohen duke përdorur kuadrin e GBIF-së www.gbif.org.

Informacioni rreth Projektit në lidhje me të cilën janë mbledhur të dhënat do të sigurohet përveç metadatave të detyrueshme të kërkuara nga GBIF. Do të përfshihet një përshkrim i shkurtër i Projektit i ndjekur nga emrat e kontraktuesve dhe themeluesve, duke përfshirë AFD-në.

Përsa i përket kushteve lidhur me përdorimin e të dhënave, siguruesi i të dhënave duhet të zgjedhë një ose të paktën dy nivele të të drejtave kufizuese, që janë: Public Domain Licence (CCo) ose Creative Common Attribution (CC-BY) Licence.

Përveç kësaj shtojce, Kontraktuesi dhe bashkëkontraktuesit e tij mund të mbështeten në Udhëzimin e Rekomandimeve Praktike për Publikimin e të Dhënave të Biodiversitetit të publikuara nga AFD-ja që mund të shkarkohet në adresën: https://www.afd.fr/en/resources/data4nature-practical-recommendations-guide-publishing-primary-biodiversity-data.